

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA KLIN.STOMATOLOGJIKE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220/70900-25-8722-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Autoklav, Unitate Stomatologjike, Tavolina Laboratorike për Punime Dentare me Sistem të Aspirimit të Integruar dhe Sistem qendror I thithjes për njësite Dentare**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Interlab SH.P.K.
NUI	601678008
Adresa	Rr. Lidhja e Pejes, Nr.75
Vendi	FusheKosove
Kodi postar	12000
Numri Telefonit	+38344517811
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Betim Sadriu
Adresa elektronike	interlab.shpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	19.06.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me Autoklav, Unitate Stomatologjike, Tavolina Laboratorike për Punime Dentare me Sistem të Aspirimit të Integruar dhe Sistem qendror I thithjes për njësite Dentare

Ne si OE kemi shfaqur interes për pjesëmarrje në tenderin me titull "Furnizim me Autoklav, Unitate Stomatologjike, Tavolina Laboratorike për Punime Dentare me Sistem të Aspirimit të Integruar dhe Sistem qendror I thithjes për njësite Dentare" dhe nr. prokurimi: 220/70900-25-8722-1-1-1.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Ne procesverbalin e hapjes ne kemi qene nje nder OE me oferte me te favorshme eknomokisht.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Pas pranimit të Njoftimit të Dytë B58 të Vendimit të AK-se, date 01.06.2026, lidhur me aktivitetin e lartcekur, ne si OE, me date 08.06.2026 kemi paraqitur Kerkese për rishqyrtim duke dhënë faktet dhe argumentet tona. Megjithatë, kjo kerkese është refuzuar me vendimin e dates 09.06.2026 ndaj të ciles parashtrojm Ankesë në OSHP.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 diskriminim në raport me interlab dhe favorizim për bora dental

Neni 28 Bora dental nuk ka plotësuar kërkesat teknike të dosjes së tenderit referuar katalogjeve të dorëzuar andaj është dashur të shpillet e papaergjeghsme oferta teknike

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 69 Katalogjet dhe ISO përfshirë deklaratat tjera bora dental nuk i ka plotësuar kërkesat e kapacitetit teknike dhe profesional andaj është dashur të kualifikohet oferta e papergjegjshme e në aspektin e perzgjedhjes/kualifikimit

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi i Rregullores për Prokurimin Publik

Neni 38 Sqarimi i Tenderëve

Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti

Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:

c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

4.3 Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për parandë për Autoritetin Kontraktues.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabje shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne, Interlab sh.p.k., si Operator Ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e lartcekur të prokurimit, parashtrorjmë këtë ankesë ndaj Vendimit të Autoritetit Kontraktues QKSUK për rishqyrtim të datës 09.06.2026, me të cilin kërkesa jonë për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.

Vendimi i AK-së është SKANDALLOZ dhe plotësisht i kundërligjshëm, i paarsyetuar, plotësisht selektiv në trajtimin e pretendimeve dhe i bazuar në vlerësim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë. AK ka aplikuar standarde të rrepta ndaj ofertës sonë, ndërsa ndaj

konzorciumit Bora Dental sh.p.k. – Madekos sh.p.k. ka toleruar mangësi esenciale teknike, administrative dhe financiare, të cilat sipas Dosjes së Tenderit dhe Ligjit për Prokurimin Publik do të duhej të rezultonin me shpalljen e ofertës së tyre si të papërgjegjshme, dhe të gjitha keto i ka arsyetuar me termin “FUNKSIONALE”. Edhe të gjitha produktet për të cilat kemi paraqitur pretendimet tona nuk plotësojnë specifikimet teknike minimale të detyrueshme.

Marre shembull produkti nr. 12 – AK në vendimin për rishqyrtim e rikonfirmon edhe njëherë se paisja në fjalë është “VARIANT” dhe sipas Dosjes së Specifikimit teknik është kërkuar:

Sistemi I Thithjes

Sistem duhet të jetë i aftë të furnizojë me thithje jo më pak se 120 njësi dentare duke garantuar vazhdimësi operimi edhe në rast defekti të një faze individuale.

Ndërsa në ofertën e Operatorit Ekonomik është deklaruar një sistem modular i cili, sipas vetë dokumentacionit/deklaratës së prodhuesit, mbulon vetëm 60 njësi dentare. Pra, kapaciteti i ofruar është vetëm gjysma e kapacitetit minimal të kërkuar në DT.

Kjo nuk është devijim formal, por mos përmbushje thelbësore teknike, sepse kapaciteti i sistemit qendror të thithjes lidhet drejtpërdrejt me funksionimin paralel të njësisve dentare, stabilitetin e vakumit, sigurinë e punës dhe vazhdimësinë e shërbimeve klinike. Një sistem i projektuar për 60 njësi nuk mund të konsiderohet ekuivalent me kërkesën për 120 njësi, pasi nuk garanton kapacitetin e nevojshëm për ngarkesën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Nuk është e njëjtë në rast defekti të një moduli, sistemi duhet të vazhdojë funksionimin me kapacitet proporcional. Pasice në rast të defektit të sistemit të Durr vazhdimi i funksionimit është vetëm gjysma e kapacitetit të kërkuar në DT të specifikimit Teknik I detyrueshem.

Prandaj, produkti/sistemi i ofruar nuk e përmbush specifikimin teknik të detyrueshëm për kapacitetin minimal të sistemit qendror të thithjes dhe si i tillë duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm për këtë kërkesë të cilin e deshmon edhe vete prodhuesi me deklaratën e dorëzuar me oferte dhe AK me vendimin e tyre të kërkesës për rishqyrtim.

Në kërkesën për rishqyrtim kemi ofruar fakte me dokumente për shkelje të Nenit 7, Nenit 28, Nenit 59, Nenit 69 dhe Nenit 72 të LPP-së, si dhe dispozitave përkatëse të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, përfshirë rregullat mbi vlerësimin “kalon/nuk kalon”, sqarimin e tenderëve dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë. Këto pretendime nuk janë trajtuar në mënyrë objektive nga AK.

AK ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim pa dhënë arsyetim të plotë dhe të bazuar në dokumentacionin teknik të dorëzuar. Në vendim, AK kryesisht përsërit konstatime të përgjithshme të komisionit vlerësues, pa analizuar në mënyrë reale faktet dhe provat e paraqitura nga Interlab sh.p.k.

Në veçanti, AK nuk ka trajtuar në mënyrë të drejtë pretendimet lidhur me: mungesën e deklaratës për instalimin e sistemit qendror dhe lidhjeve të gypave deri tek secili unit dentar; për pozicionin nr. 12 – Sistemi Qendror i Thithjes ku I mundeson ; ofrimin e varianteve të paautorizuara nga konzorciumi Bora Dental – Madekos; mosplotësimet teknike të produkteve të

ofruara nga konzorciumi i rekomanduar për kontratë; aplikimin e standardeve të dyfishta në vlerësimin e ofertës sonë dhe ofertës së rekomanduar.

Kërkesa për rishqyrtim ka theksuar qartë se dokumentacioni i konzorciumit Bora Dental – Madekos është i mangët, i paqartë dhe me elemente që kanë vendosur në lajthitje Autoritetin Kontraktues. Po ashtu është theksuar se për të njëjtin operator dhe për te njëjtat pika janë toleruar mangësi që për Interlab janë trajtuar si arsye eliminimi, edhe pse në Operator Ekonomik kemi ofruar dokumentacione të nevojshme për të hedhur poshtë keto pretendime.

TRAJTIM I PABARABARTË DHE STANDARDE TË DYFISHTA

AK, në kundërshtim me Nenin 7 të LPP-së, ka aplikuar standarde të ndryshme ndaj operatorëve ekonomikë.

Në rastin e ofertës sonë Interlab sh.p.k., AK ka konsideruar se disa parametra teknike nuk janë dëshmuar mjaftueshëm në katalog, edhe pse produktet janë të identifikuar qartë, prodhuesit janë ndër më të njohurit në treg dhe çdo paqartësi eventuale ka mundur të sqarohet përmes dokumentacionit shtesë, pa ndryshuar ofertën.

Në anën tjetër, për konzorciumin Bora Dental – Madekos, AK ka pranuar dokumentacion të paqartë, katalogje me produkte alternative, mungesa të dokumenteve të domosdoshme, si dhe mosplotësime teknike të cilat nuk mund të korrigjohen përmes sqarimeve, sepse përbëjnë devijime materiale nga Dosja e Tenderit.

Kjo qasje përbën diskriminim ndaj Interlab sh.p.k. dhe favorizim të ofertuesit të rekomanduar për kontratë.

OFERTA E KONZORCIUMIT BORA DENTAL – MADEKOS ËSHTË E PAPËRGJEGJSHME

KUNDËRSHTIM I PËRGJIGJEVE TË AK-SË NDAJ PRETENDIMEVE ANKIMORE

Parashtruesi i ankesës, Interlab sh.p.k., kundërshton në tërësi përgjigjet e dhëna nga Autoriteti Kontraktues, pasi të njëjtat janë të përgjithshme, të paargumentuara teknikisht dhe në shumicën e rasteve nuk adresojnë thelbin e pretendimeve tona. AK, në vend që të analizojë dokumentacionin e dorëzuar nga konzorciumi Bora Dental sh.p.k. – Madekos sh.p.k. në raport me kërkesat e Dosjes së Tenderit, ka marrë si të mirëqena pretendimet e ofertuesit të rekomanduar dhe ka mbrojtur ofertën e tij pa bazë të mjaftueshme dokumentare. Këto kundërshtime bazohen në përgjigjet e AK-së dhe komentet tona të paraqitura për secilin pretendim.

1. Mungesa e deklaratës / planit për instalimin e sistemit qendror të thithjes

AK pretendon se Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar deklaratë specifike si dokument të veçantë dhe se konzorciumi Bora Dental – Madekos ka dorëzuar plan të detajuar të instalimit të sistemit të gypave të aspirimit.

Ky arsyetim kundërshtohet si i pabazuar, sepse gjatë qasjes në dokumentacionin e ofertës nuk na është ofruar asnjë dokument i tillë, as si dokument i veçantë dhe as si pjesë përbërëse e ofertës së konzorciumit Bora Dental – Madekos. Dokumenti për të cilin AK pretendon se është dorëzuar nuk figuron në dokumentacionin e qasjes dhe nuk është dëshmuar ekzistenca e tij.

Nëse AK e ka bazuar vlerësimin në një dokument që nuk është ofruar në qasje dhe nuk figuron në dosjen e ofertës së dorëzuar, atëherë kemi të bëjmë me shkelje të transparencës, trajtimit të barabartë dhe të drejtës së operatorit ekonomik për qasje të plotë në dokumentacionin relevant të vlerësimit.

Për më tepër, AK nuk mund të refuzojë pretendimin tonë duke u thirrur në një dokument të pidentifikuar, të pacituar dhe të paofruar si pjesë e qasjes.

ARTIKULLI 1 Tavoline e punes per Teknik dentar

2. Paqartësia mbi modelin e dritës së tavolinës së ofruar

AK ka refuzuar pretendimin tonë duke deklaruar se operatori i rekomanduar ka nënvizuar qartësisht dritën nga prodhuesi Renfert, modeli Light 1.

Ky arsyetim është i pabazuar, sepse pretendimi ynë nuk ka qenë vetëm mungesa e nënvizimit të një modeli, por fakti se në dokumentacionin e ofertës janë paraqitur disa produkte për të njëjtin pozicion: dritë nga prodhuesi Zeising dhe dritë nga prodhuesi Renfert, përfshirë edhe kode të ndryshme produkti. Kjo krijon paqartësi esenciale mbi produktin real të ofruar.

Dosja e Tenderit nuk ka lejuar variante. Prandaj, ofertuesi ka qenë i obliguar të paraqesë një konfigurim të vetëm, të qartë dhe të verifikueshëm. AK nuk ka adresuar këtë element, por vetëm ka deklaruar se një model është nënvizuar. Nënvizimi i një modeli nuk e eliminon faktin se në dokumentacion figurojnë produkte alternative për të njëjtin funksion.

Kjo tregon se AK ka mbrojtur ofertën e konzorciumit të rekomanduar, pa analizuar plotësisht dokumentacionin dhe pa marrë parasysh pasojat juridike të paraqitjes së varianteve të paautorizuara.

3. Mungesa e kasetës tërheqëse sipas standardeve EN/DIN/ASTM

AK ka refuzuar pretendimin tonë duke deklaruar se operatori i rekomanduar ka ofruar pajisjen në përputhje me standardet EN/DIN të kërkuara.

Ky arsyetim nuk e trajton fare thelbin e pretendimit. Pretendimi ynë nuk ka qenë vetëm te standardi EN/DIN si emërtim, por te ekzistenca fizike dhe funksionale e kasetës së kërkuar nga Dosja e Tenderit.

Dosja e Tenderit ka kërkuar qartë që kasetë të ketë mekanizëm automatik tërheqjeje të tubit përmes sustës me dy spirale, lidhje të ajrit të kompresuar të integruar në panelin anësor, mbajtës të pjerrët për vendosjen e grykës së ajrit dhe konstrukcion nga çelik inox ose çelik i veshur sipas EN/DIN/ASTM.

Në ofertën e konzorciumit Bora Dental – Madekos është ofruar NSK Ultimate XL, i cili nuk posedon kasetë metalike të fshehur me mekanizëm tërheqës me sustë me dy spirale. Ky mekanizëm i detyrueshëm mungon plotësisht.

Pra, nuk mjafton që AK të deklarojë në mënyrë të përgjithshme se pajisja është “në përputhje me standardet EN/DIN”. AK është dashur të tregojë se ku në katalogun e dorëzuar dëshmohet mekanizmi i kërkuar. Meqenëse ky element nuk ekziston në dokumentacionin e ofertës, oferta e konzorciumit është teknikisht e papërgjegjshme.

4. Materiali i sirtarit të mbledhjes së mbetjeve

AK ka refuzuar pretendimin duke deklaruar se është ofruar tavolinë me kornizë alumini, rezistente ndaj konsumimit, lagështirës dhe ndikimeve mekanike.

Ky arsyetim është jashtë objektit të pretendimit. Kërkesa në Dosjen e Tenderit nuk i referohet vetëm kornizës së tavolinës, por specifiku sirtarit të mbledhjes së mbetjeve. Dosja ka kërkuar që ky sirtar të jetë prej materiali rezistent ndaj korrozionit dhe kimikateve laboratorike, si dhe të jetë i përshtatshëm për pastrim me ujë të nxehtë ose avull.

AK nuk ka dëshmuar se sirtari i ofruar i përmbush këto kërkesa. Përkundrazi, në dokumentacionin e ofruar nuk dëshmohet se materiali plastik i sirtarit mund të përballojë pastrimin me avull të nxehtë me presion pa deformim termik.

Fakti që korniza e tavolinës është alumini nuk e plotëson automatikisht kërkesën për sirtarin e mbetjeve. AK ka ngatërruar komponentët e tavolinës dhe nuk ka analizuar parametrin teknik të kërkuar.

5. Dollapi me tre sirtarë dhe rezistenca ndaj lagështirës / korrozionit

AK ka refuzuar pretendimin duke u thirrur përsëri në kornizën e aluminit të tavolinës.

Ky arsyetim është i mangët dhe nuk i përgjigjet pretendimit tonë. Dosja e Tenderit ka kërkuar që tavolina të përfshijë dollap dysHEMEJE me tre sirtarë për ruajtje, me grykë ajri të integruar si pjesë e konfigurimit funksional. Po ashtu është kërkuar që dollapët të jenë nga materiale rezistente ndaj lagështirës dhe kimikateve, me mbrojtje kundër korrozionit dhe skaje të mbyllura hermetikisht.

Dollapi i ofruar nga Zeising ka ndërtim standard laboratorik me skaje të mbrojtura me shirita PVC/ABS. Skajet e ngjitura me shirit ABS nuk përbëjnë mbyllje hermetike ndaj depërtimit të lëngjeve ose gazrave kimikë në rast derdhjeje.

AK nuk ka treguar asnjë dëshmi teknike që vërteton se skajet janë realisht të mbyllura hermetikisht. Prandaj, konstatimi i AK-së se kërkesa është plotësuar është i paargumentuar dhe nuk mbështetet në

dokumentacion teknik.

6. Skajet PVC/ABS nuk përbëjnë mbyllje hermetike

AK ka deklaruar se operatori i rekomanduar ka plotësuar kërkesat për skaje të mbyllura hermetikisht.

Ky konstatim është deklarativ dhe pa bazë teknike. Mbyllja hermetike nënkupton pengimin e depërtimit të lëngjeve, lagështirës, avujve ose substancave kimike në strukturën e materialit. Shiritat PVC/ABS të ngjitur në skaje nuk janë të barasvlershëm me mbyllje hermetike, sidomos në ambient laboratorik dentar ku ekziston kontakt i vazhdueshëm me pluhur, kimikate, lagështi dhe materiale të ndryshme laboratorike.

AK nuk ka paraqitur asnjë certifikatë, deklaratë prodhuesi apo dokument teknik që vërteton se ky sistem i skajeve është hermetik. Prandaj, përgjigjja e AK-së është e pabazuar.

7. Certifikata ISO 13485:2016 për mikromotorin NSK Ultimate XL

AK ka deklaruar se vlefshmëria e dokumenteve vlerësohet në momentin e skadimit të afatit për dorëzim të tenderëve, datë në të cilën certifikata ISO 13485 ka qenë ende valide.

Ky arsyetim është i paplotë dhe nuk e trajton faktin se procedura ka vazhduar dhe është kthyer në rivlerësim. Certifikata e dorëzuar për prodhuesin Nakanishi/NSK ka skaduar më 26.04.2026, ndërsa vlerësimi dhe rivlerësimi kanë vazhduar pas kësaj date.

Në një procedurë që kthehet në rivlerësim dhe ku AK ka mundësi të kërkojë dokumente plotësuese për sqarim sipas Nenit 72 të LPP-së, AK është dashur të verifikojë nëse certifikata ISO 13485 vazhdon të jetë valide. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për certifikatë të menaxhimit të cilësisë për pajisje që janë pjesë e ofertës teknike.

Për më tepër, AK ka kërkuar dhe pranuar dokumente shtesë për operatorë të tjerë, ndërsa nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë çështjen e validitetit aktual të certifikatës ISO 13485. Kjo përbën trajtim selektiv dhe standard të dyfishtë.

8. Fuqia e mikromotorit të ofruar

AK ka refuzuar pretendimin duke u fokusuar vetëm në torque prej 8.7 Ncm dhe duke deklaruar se ky parametër e tejkalon kërkesën minimale prej 7 Ncm.

Ky arsyetim është i mangët, sepse Dosja e Tenderit ka kërkuar dy parametra kumulativë: torque minimal prej 7 Ncm ose më shumë dhe fuqi daljeje jo më pak se 150 W. Plotësimi i njërit parametër nuk e zëvendëson mosplotësimin e parametrit tjetër.

NSK Ultimate XL, sipas dokumentacionit teknik, ka njësi kontrolluese me konsum prej 46 VA, që nuk dëshmon fuqi daljeje prej 150 W. AK nuk ka paraqitur asnjë dokument ku dëshmohet qartë se mikromotori i ofruar ka fuqi daljeje minimale prej 150 W.

Prandaj, përgjigjja e AK-së është e paplotë dhe nuk e rrëzon pretendimin tonë. Në mungesë të dëshmisë për 150 W fuqi daljeje, oferta duhet të konsiderohet teknikisht e papërgjegjshme.

9. Dokumenti i konformitetit EC i prodhuesit Zeising

AK ka deklaruar se kërkesa për CE dhe Deklaratë të Pajtushmërisë sipas MDR zbatohet vetëm për pajisjet mjekësore dhe se tavolina e punës për teknikun dentar nuk klasifikohet si pajisje mjekësore sipas MDR-së.

Ky arsyetim nuk e trajton thelbin e pretendimit tonë. Ne nuk kemi pretenduar vetëm se tavolina duhet domosdoshmërisht të ketë MDR, por kemi kontestuar validitetin e dokumentit të konformitetit EC të dorëzuar nga vetë konzorciumi.

Dokumenti i dorëzuar nga prodhuesi Zeising është i dyshimtë dhe jo valid, sepse nuk përmban përshkrim të qartë të produktit për të cilin deklarohet konformiteti, nuk përmban vulë ose nënshkrim të qartë të personit përgjegjës dhe referon direktiva të vjetruara.

Në dokument janë cituar direktiva që nuk janë më në fuqi, përfshirë:

Direktiva e Makinerive 98/37/EC, e zëvendësuar nga Direktiva 2006/42/EC;
Direktiva EMC 2004/108/EG, e zëvendësuar nga Direktiva 2014/30/EU;
Direktiva e Tensionit të Ulët 2006/95/EG, e zëvendësuar nga Direktiva 2014/35/EU;
standartet EN 12100-1 dhe EN 12100-2, të zëvendësuara nga EN ISO 12100:2010.

Prandaj, edhe nëse MDR nuk aplikohet për tavolinën, dokumenti i dorëzuar si deklaratë konformiteti është i pavlefshëm dhe nuk mund të shërbejë si dëshmi teknike për produktin e ofruar.

10. Përgjigjja e AK-së për dallimin mes konsumit elektrik dhe fuqisë funksionale

AK ka deklaruar se kemi ngatërruar dy parametra: konsumin elektrik të njësisë kontrolluese dhe fuqinë funksionale dalje të mikromotorit.

Edhe ky arsyetim është i pabazuar, sepse barra për të dëshmuar përputhshmërinë me kërkesat e DT-së bie mbi ofertuesin dhe AK-në gjatë vlerësimit. Nëse AK pretendon se mikromotori ka fuqi daljeje 150 W, atëherë duhet të tregojë ku në katalog apo manual dëshmohet ky parametër.

Në dokumentacionin e ofruar për NSK Ultimate XL, parametri i identifikueshëm është 46 VA për njësinë kontrolluese. Nuk është paraqitur dëshmi e qartë për fuqi daljeje 150 W. Pra, AK nuk mund të rrëzojë pretendimin tonë vetëm duke thënë se bëhet fjalë për dy parametra të ndryshëm, pa treguar dokumentin ku dëshmohet parametri i kërkuar.

Për më tepër, pajisja e ofruar nuk posedon as sistemin e kasetës së fshehur me tërheqje automatike, por vetëm mbajtëse të thjeshtë mbi tavolinë dhe kordon të lirë. Kjo përforcon faktin se konfigurimi i ofruar është më i dobët se ai i kërkuar.

11. Sistemi i filtrimit i thithëses Renfert Silent TS

AK ka deklaruar se Renfert Silent TS është ofruar me sistem të dyfishtë filtrimi HEPA dhe se kjo e plotëson kërkesën e DT-së.

Ky arsyetim nuk përputhet me kërkesën e Dosjes së Tenderit. DT ka kërkuar sistem filtrimi shumëfazësh që përfshin qese filtrimi, mikrofiltër me efikasitet të lartë dhe filtër për neutralizimin e aromave.

Renfert Silent TS mund të ketë filtër pluhuri dhe mikrofiltrim, por nuk dëshmohet se ka filtër specifik për neutralizimin e aromave, si p.sh. filtër me karbon aktiv të integruar ose të përshtatshëm për këtë funksion.

Pra, AK ka zëvendësuar kërkesën specifike për neutralizim aromash me një konstatim të përgjithshëm mbi filtrimin HEPA. Kjo nuk është e mjaftueshme dhe nuk e plotëson kërkesën e DT-së.

12. Rregullimi automatik i fuqisë së thithëses Renfert Silent TS

AK ka deklaruar se Renfert Silent TS disponon rregullim automatik të fuqisë sipas ngarkesës së punës.

Ky konstatim kundërshtohet, sepse në modelet Renfert rregullimi i vazhdueshëm automatik sipas ngarkesës së punës lidhet kryesisht me modele më të avancuara si EC2 ose TC2, ndërsa te Silent TS fuqia rregullohet manualisht në nivele nga përdoruesi/tekniku.

Kërkesa e DT-së nuk ka qenë vetëm që pajisja të ketë disa nivele fuqie, por që të ketë rregullim automatik të fuqisë së thithjes sipas ngarkesës së punës. AK nuk ka treguar asnjë dokument teknik ku dëshmohet se modeli Silent TS e realizon këtë funksion në mënyrë automatike sipas ngarkesës reale.

Në mungesë të kësaj dëshmie, oferta nuk e plotëson kërkesën minimale.

13. Sirtari i mbledhjes së mbetjeve i thithëses Renfert

AK ka deklaruar se dokumentacioni teknik i prodhuesit Renfert konfirmon se pajisja është projektuar për pastrim dhe mirëmbajtje të lehtë dhe se nuk ka kufizim për pastrim me ujë të nxehtë ose avull.

Ky arsyetim është i pamjaftueshëm. Dosja e Tenderit ka kërkuar qartë që sirtari i mbledhjes së mbetjeve të jetë i përshtatshëm për pastrim me ujë të nxehtë ose avull. Sistemet Renfert mbledhin pluhurin në qese letre/sintetike brenda sirtarit. Sirtari në këtë rast është mbajtës i qeses dhe jo sirtar mbetjesh i projektuar për t'u pastruar në mënyrë të pavarur me ujë të nxehtë ose avull pas përdorimit.

AK nuk ka paraqitur asnjë dëshmi nga prodhuesi që sirtari i këtij modeli është i dizajnuar për pastrim me avull. Përkundrazi, formulimi “pastrim dhe mirëmbajtje e lehtë” nuk është i barasvlershëm me kërkesën specifike të DT-së për pastrim me ujë të nxehtë ose avull.

14. Instalimi i gazit dhe standardi DIN 30665

AK ka deklaruar se standardi gjerman DIN 30665 është standard rigoroz dhe ekuivalent me standardet EN/ISO të kërkuara.

Ky arsyetim është i pabazuar, sepse vetë fakti që një standard është gjerman ose i njohur në industri nuk e bën automatikisht ekuivalent me standardet EN/ISO. Dosja e Tenderit ka kërkuar standarde EN/ISO ose ekuivalente. Nëse ofertuesi ofron një standard tjetër kombëtar, si DIN 30665, ai duhet të dëshmojë barasvlershmërinë teknike me standardin e kërkuar.

Konzorciumi Bora Dental – Madekos nuk ka ofruar asnjë certifikatë, deklaratë prodhuesi apo dokument teknik që vërteton se DIN 30665 është ekuivalent i plotë me standardet EN/ISO të kërkuara nga AK.

Prandaj, AK nuk ka mundur ta pranojë këtë si të plotësuar vetëm mbi bazën e një konstatimi të përgjithshëm.

ARTIKULLI 2 Karrige Laboratorike

15. Karrigia laboratorike e ofruar nga konzorciumi

AK ka refuzuar pretendimin tonë duke deklaruar se Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar specifika të detajuara për materialin apo llojin e karriges dhe se çmimi është brenda vlerës së parashikuar.

Ky arsyetim është i mangët dhe nuk trajton parimin e vlerës për paranë publike. Edhe kur specifikimet teknike nuk janë të detajuara, AK ka obligim që të sigurojë që produkti i ofruar është i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit dhe që çmimi nuk është më i lartë se çmimi real i tregut.

Karrigia laboratorike e ofruar nga konzorciumi, sipas dokumentacionit, paraqitet si karrige druri e thjeshtë, e cila nuk është e përshtatshme për përdorim të gjatë në laborator dentar, ku tekniku punon për periudha të gjata dhe kërkohet ergonomi, stabilitet dhe material i përshtatshëm për ambient laboratorik.

Çmimi i ofruar prej 1,168.20 euro për copë është dukshëm joproportional me natyrën e produktit të paraqitur. Edhe nëse Dosja e Tenderit nuk ka vendosur specifika të hollësishme, AK ka obligim sipas Rregullores Nr. 001/2022, Neni 4, që të sigurohet se çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut dhe se prokurimi siguron vlerë për paranë publike.

Prandaj, AK nuk mund të arsyetohet vetëm me faktin se çmimi është brenda vlerës së parashikuar. Vlera e parashikuar nuk e legjitimon automatikisht një çmim të pajustificuar për një produkt të thjeshtë dhe të papërshtatshëm për laborator dentar.

ARTIKULLI 3 Sistemi lavatriçe/dezinfektuese

Pretendimi 15 Sistemi lavatriçe/dezinfektuese MELAtherm 10 Evolution nuk disponon programin e kërkuar për largimin e ajrit nga tubacionet.

AK ka deklaruar se pajisja është e projektuar për reprocessimin e instrumenteve me tubacione dhe disponon funksione për qarkullim aktiv të fluidit dhe largim të ajrit. mirepo AK nuk ka trajtuar kërkesën kryesore të DT-së: ekzistencën e një programi të veçantë për largimin e ajrit nga tubacionet. Pra, ka dhene nje pergjigje te pergjithshme dhe nuk a deshmuar ekzistencen e programit te kerkuar ne specikiat teknike te DT.

Pretendimi 16 Sistemi lavatriçe/dezinfektuese nuk disponon program të veçantë për rigjenerimin e njësisë së brendshme të zbutjes së ujit.

AK ka deklaruar se pajisja ka njësi të integruar për zbutjen e ujit dhe funksion automatik rigjenerimi përmes kripës duke mos e trajtuar faktin se DT ka kërkuar program për rigjenerimin e njësisë së brendshme të zbutjes së ujit, jo vetëm funksion automatik.

Pretendimi 17 Pajisja nuk lejon përditësimin e firmware-it përmes mediave të jashtme nga përdoruesi. AK ka deklaruar se pajisja disponon lidhje për media të jashtme, si USB, CF card dhe rrjet. Por nuk ka trajtuar dallimin ndërmjet pranisë fizike të portave dhe mundësisë reale për firmware update përmes atyre portave.

Pretendimi 18 Pajisja nuk ofron ndërprerje të pastër të fazës së tharjes pa gjeneruar mesazhe gabimi. AK ka thënë se DT kërkon vetëm mundësinë e ndërprerjes së fazës së tharjes nga përdoruesi dhe nuk kërkon që kjo të bëhet pa mesazhe gabimi. AK nuk ka trajtuar pasojën funksionale të ndërprerjes së tharjes.

Artikulli 6 Autokllava

Pretendimi 19 Madhësia e ekranit të autoklavës nuk plotëson kërkesën minimale prej jo më pak se 7 inch. AK ka deklaruar se dokumentacioni dhe broshura e prodhuesit tregojnë se pajisja ka “2 colour touch display XXL”. AK nuk ka trajtuar kriterin e kërkuar në DT: minimum 7 inch.

Pretendimi 20 Kapaciteti i memories për ruajtjen e cikleve nuk plotëson minimumin prej 150 cikleve.

AK ka thënë se Cliniclave 45 MD plotëson kërkesat për ruajtje dhe dokumentim të cikleve përmes funksioneve të integruara të dokumentimit dhe traceability duke mos e trajtuar numrin konkret të cikleve që ruhen në memorien e brendshme.

Pretendimi 21 për rezervuarin e brendshëm të ujit 15 L

DT ka kërkuar që pajisja të ketë rezervuar të brendshëm të ujit prej 15 litrash, ky pretendim nuk është shqyrtuar fare në mënyrë të arsyetuar nga AK dhe nuk ka treguar asnjë provë teknike për ekzistencën

e rezervuarit të brendshëm 15 L.

Pretendimi 22 Sistemi i tharjes dhe gjeneratori i avullit i autoklavës nuk funksionon me teknologjinë e dhomës binjake sipas kërkesave të DT-së.

AK nuk ka shqyrtuar në thelb pretendimin tone, sepse nuk ka analizuar nëse double jacket technology është e njëjtë me dhomë binjake, nuk ka provuar se gjeneratori i avullit është i integruar në dhomë binjake dhe nuk ka dëshmuar se sistemi i tharjes është me vakum të thellë sipas kërkesës së DT-së.

Pretendimi 23 Autoklava nuk është në përputhje me standardin EN 60601-1-2 për EMC sipas kërkesave të DT-së.

Sa i përket këtij pretendimi AK nuk ka shqyrtuar faktin kryesor se DT ka kërkuar shprehimisht standardin EN 60601-1-2 për EMC, ndërsa Deklarata e Konformitetit e prodhuesit për Cliniclave 45 MD nuk e përmban këtë standard.

AK ka pranuar standarde të tjera, si EN 61326-1 dhe EN 61010, pa dëshmuar ekuivalencën e tyre me EN 60601-1-2 dhe pa treguar se DT ka lejuar standarde alternative.

ARTIKULLI 7 Skaner Intraoral me Stacion Mobil të Integruar

Pretendimi ankimor 24 – Pesha e kamerës së skanerit intraoral

AK ka refuzuar pretendimin tonë me arsyetimin se pajisja është ergonomike, kompakte dhe e përshtatshme për përdorim klinik të vazhdueshëm.

Ky arsyetim është i pabazuar dhe jashtë kërkesës konkrete të Dosjes së Tenderit. AK nuk ka kërkuar vetëm “ergonomi” apo “përshtatshmëri klinike” në mënyrë të përgjithshme, por ka përcaktuar një kriter teknik të matshëm dhe të detyrueshëm: **pesha e skanerit intraoral të jetë ≤ 400 g.**

Në ofertën e Grupit të Operatorëve Ekonomik Bora Dental sh.p.k. dhe Madekos sh.p.k., për Pozicionin 7 është deklaruar modeli **Primescan** i prodhuesit Dentsply Sirona. Sipas të dhënave teknike zyrtare të prodhuesit, pesha e këtij skaneri është:

457 g me plastic sleeve;

524.5 g me metal sleeve.

Pra, edhe në konfigurimin më të lehtë të deklaruar nga prodhuesi, skaneri është mbi kufirin maksimal prej 400 g të kërkuar në DT.

AK nuk mund ta zëvendësojë një kriter teknik numerik me vlerësime subjektive për ergonomi. Kur DT kërkon peshë ≤ 400 g, çdo pajisje mbi këtë kufi është teknikisht e papërgjegjshme, pavarësisht reputacionit të prodhuesit apo përdorimit ndërkombëtar të pajisjes.

Ky është devijim material dhe nuk mund të trajtohet si ekuivalencë funksionale.

Pretendimi ankimor 26 – Mungesa e tipave standard, pediatrik dhe mini, si dhe ndërlidhja USB 3.0 / Type-C

AK ka deklaruar se pajisja ofron tipa/skaner heads të përshtatshëm për përdorim klinik dhe se kërkesa funksionale është përmbushur, pavarësisht emërimit komercial të përdorur nga prodhuesi. Po ashtu, AK ka deklaruar se pajisja mundëson ndërlidhje përmes porteve USB.

Ky arsyetim nuk qëndron.

Në DT është kërkuar që skaneri të ketë tipa me madhësi të ndryshme, përfshirë:

standard;

pediatrik;

mini.

Nga dokumentacioni i paraqitur dhe të dhënat zyrtare të prodhuesit Primescan nuk dëshmohet se pajisja posedon **tip pediatrik**. Prodhuesi liston sleeves/tipa të ndryshëm, por asnjëri nuk deklarohet si tip pediatrik apo si tip i dedikuar për përdorim pediatrik.

Kjo nuk është çështje emërimi komercial, por kërkesë funksionale. Një institucion publik shëndetësor duhet të ketë pajisje të përshtatshme për pacientë të grupmoshave të ndryshme, përfshirë fëmijët.

Mungesa e tipit pediatrik e bën pajisjen të papërshtatshme për përdorim të plotë sipas kërkesës së DT-së.

Po ashtu, në DT është kërkuar ndërlidhje **USB 3.0 / Type-C**, ndërsa në dokumentacionin teknik të paraqitur është deklaruar **USB 2.0**. USB 2.0 nuk mund të konsiderohet ekuivalent me USB 3.0 / Type-C, pasi paraqet standard më të vjetër, me kapacitet më të ulët të transferimit dhe jo në përputhje me kërkesën e shprehur qartë në DT.

Prandaj, AK ka gabuar kur ka trajtuar këtë kërkesë si të përmbushur.

ARTIKULLI 8 Skaner Intraoral me Stacion Mobil të Integruar

Pretendimi 27 – Unit Dentar

AK ka refuzuar një pretendim lidhur me çmimin e pajisjes në pozicionin 8, duke u thirrur në nenet 59 dhe 60 të LPP-së dhe duke deklaruar se kontratat e mëparshme nuk janë referencë krahasuese.

Ky arsyetim është i pavend, sepse në pretendimet tona nuk është kontestuar fare çmimi për pozicionin 8. AK ka dhënë përgjigje për një çështje që nuk është ngritur nga ne në këtë formë.

Kjo tregon mungesë të trajtimit të saktë dhe serioz të pretendimeve ankimore. Në vend që AK të përgjigjet në pretendimet konkrete teknike, ka futur arsyeime që nuk lidhen me bazën reale të ankesës.

Për këtë arsye, kjo përgjigje duhet të konsiderohet e paqëndrueshme dhe e parëndësishme për vlerësimin e pretendimeve tona.

Pretendimi 28 – Gjatësia e tubave të instrumenteve të Uniti Dentar

AK ka deklaruar se nga dokumentacioni teknik për pajisjen Intego/Intego Pro rezulton se tubat e instrumenteve kanë gjatësi 1660 mm, duke përmbushur kërkesën minimale të DT-së.

Ky konstatim kundërshtohet në tërësi, pasi në katalogun e ofruar dhe në produktin e nënvizuar në ofertë rezulton gjatësi prej vetëm **900 mm**, pra dukshëm më pak se minimumi i kërkuar.

Në DT është kërkuar gjatësi minimale e tubave të instrumenteve prej **1300 mm**. Produkti i deklaruar me gjatësi 900 mm është 400 mm më i shkurtër se minimumi i kërkuar.

Ky devijim është thelbësor, sepse gjatësia e tubave ndikon drejtpërdrejt në:

lëvizshmërinë e mjekut;

ergonominë gjatë punës;
qasje të lirë rreth pacientit;
përdorimin praktik të instrumenteve;
sigurinë dhe komoditetin gjatë procedurave stomatologjike.
Tubat prej vetëm 900 mm kufizojnë hapësirën efektive të manovrimit dhe e detyrojnë mjekun të punojë në pozicione më pak ergonomike. Prandaj, produkti i ofruar nuk e plotëson specifikimin teknik të DT-së dhe oferta duhet të konsiderohet e papërgjegjshme për këtë pikë.

Pretendimi 29 – Materiali i pështymores te Uniti Dentar

AK ka deklaruar se pështymorja e unitit dentar është nga porcelani dhe se kjo shihet qartë në broshurën e prodhuesit.

Ky arsyetim është i pabazuar. Në DT për Pozicionin 8 – Uniti Dentar është kërkuar qartë që pështymorja të jetë nga materiali **porcelan**. Produkti i deklaruar nga grupi i OE është nga **qelqi**, prandaj nuk e përmbush materialin e kërkuar.

Ky nuk është devijim formal, por teknik dhe funksional. Porcelani është më i përshtatshëm për përdorim klinik intensiv sepse është më rezistent ndaj:

gërvishtjeve;

njollave;

dezinfektuesve;

temperaturave të larta;

pastrimit të shpeshtë dhe sterilizimit.

Në anën tjetër, pështymorja nga qelqi është më e ndjeshme ndaj goditjeve, thyerjes dhe dëmtimit gjatë çmontimit, pastrimit apo sterilizimit. Prandaj, qelqi nuk mund të konsiderohet ekuivalent me porcelanin kur DT ka kërkuar qartë porcelan.

AK nuk ka ofruar dëshmi të qartë teknike që produkti i deklaruar është me pështymore porcelani.

ARTIKULLI 9- Unit Dentar sipas ISO7494

Pretendimi 30 – Ekрани touch me ngjyra te Uniti Dentar

AK ka refuzuar pretendimin për ekranin me touch me ngjyra, duke u mbështetur në faktin se pajisja posedon sistemin EasyTouch.

Ky arsyetim është i mangët, sepse DT ka kërkuar qartë ekran me touch me ngjyra me madhësi jo më pak se **7 inch** dhe rezolucion **800 × 480 px**.

Produkti i deklaruar posedon sistemin **EasyTouch**, i cili është ekran **4.3 inch**, pra dukshëm më i vogël se minimumi i kërkuar prej 7 inch.

Rezolucioni 800 × 480 px në DT është kërkuar për një ekran më të madh, minimum 7", ku informacionet mund të lexohen dhe menaxhohen lehtësisht gjatë punës klinike. Ofrimi i ekranit 4.3" nuk mund të konsiderohet ekuivalent me ekranin 7", sepse paraqet zgjidhje më të vogël, më të kufizuar dhe funksionalisht më të dobët.

Ky devijim ndikon në përdorimin praktik të unitit dentar, pasi ekranin më të madh ofron:

pamje më të qarta;

ikona më të lexueshme;

qasje më të lehtë në funksione;

kontroll më të mirë të parametrave dhe alarmeve gjatë punës klinike.

Prandaj, oferta nuk e përmbush kërkesën e DT-së.

Pretendimi 31 – Torque i mikromotorit elektrik te Uniti Dentar

AK ka deklaruar se motorët elektrikë të pajisjes Intego/Intego Pro posedojnë torque deri në rreth 3.0 Ncm dhe se përmbushin kërkesën e DT-së.

Ky arsyetim nuk është në përputhje me produktin relevant të deklaruar në ofertë. Nga dokumentacioni teknik i motorëve Dentsply Sirona, për modelin relevant **Electric motor BL E with LED**, i përshtatshëm për Intego / Intego Pro, torque i deklaruar është rreth **2.4 Ncm**, jo 2.7 Ncm.

DT ka kërkuar torque minimal prej **2.7 Ncm**. Një mikromotor me torque 2.4 Ncm nuk e përmbush këtë kërkesë.

Torque është parametër teknik i rëndësishëm për performancën e mikromotorit. Torque më i ulët nënkupton forcë më të ulët rrotulluese, sidomos në procedura ku kërkohet stabilitet, fuqi dhe performancë konstante.

Prandaj, një mikromotor me 2.4 Ncm nuk mund të barazohet me kërkesën 2.7 Ncm.

Pretendimi 32 – Materiali i pështymores te Uniti Dentar sipas ISO 7494

AK ka përsëritur arsyetimin se pështymorja është nga porcelani dhe se kjo dëshmohet në broshurën e prodhuesit.

Edhe për Pozicionin 9 – Uniti Dentar sipas ISO 7494, ky arsyetim kundërshtohet. DT ka kërkuar qartë pështymore nga materiali **porcelan**, ndërsa produkti i deklaruar nga grupi i OE është nga **qelqi**.

Qelqi nuk e plotëson kërkesën për porcelan dhe nuk mund të konsiderohet ekuivalent, për shkak të dallimeve në qëndrueshmëri, rezistencë ndaj gërvishtjeve, rezistencë ndaj dezinfektuesve dhe përshtatshmëri për pastrim/sterilizim të përsëritur.

Pështymorja nga qelqi është më e ndjeshme ndaj dëmtimeve mekanike dhe thyerjes gjatë përdorimit të përditshëm klinik. Prandaj, oferta nuk e përmbush specifikimin teknik të DT-së.

ARTIKULLI 10- Njësi dentare sipas ISO 7494 me dritë të avancuar pa puls

Pretendimi 33 – Ekran i Uniti Dentar sipas ISO 7494

AK ka deklaruar se DT ka lejuar teknologjinë EasyTouch apo ekuivalent dhe se pajisja e ofruar posedon EasyTouch.

Ky arsyetim nuk është i mjaftueshëm. DT ka kërkuar ekran me prekje me ngjyra në të dy anët, me madhësi jo më pak se **7 inch**, rezolucion 800 × 480 px dhe teknologji IPS ose EasyTouch/ekuivalent. Fakti që pajisja posedon EasyTouch nuk e përmbush automatikisht kërkesën për madhësi minimale 7 inch. EasyTouch i deklaruar është ekran **4.3 inch**, pra më i vogël se minimumi i kërkuar.

AK ka trajtuar vetëm emërtimin e teknologjisë, por ka anashkaluar kriterin numerik të madhësisë së ekranit. Një ekran 4.3” nuk mund të konsiderohet ekuivalent me ekran 7”, sepse ka sipërfaqe dukshëm më të vogël pune, lexueshmëri më të ulët dhe kufizim funksional gjatë përdorimit klinik. Prandaj, pajisja nuk e përmbush kërkesën e DT-së.

ARTIKULLI 11- Uniti DENTAR –Kirurgjik

Pretendimi 34 – Turbina me kokë 45° te Uniti Dentar Kirurgjik

AK ka deklaruar se është ofruar turbina T1 Boost dhe se ajo përmbush funksionalisht kërkesat teknike për përdorim kirurgjik.

Ky arsyetim është i pabazuar. Në DT është kërkuar qartë që për unitin dentar kirurgjik të ofrohet **turbinë me kokë të kthyer në kënd prej 45°**.

Kjo nuk është kërkesë dekorative apo e përgjithshme ergonomike, por kërkesë teknike dhe klinike

shumë specifike. Turbina 45° përdoret veçanërisht në procedura kirurgjike dentare, sidomos në: zona me qasje të vështirë;

regjion posterior;

ekstraksione kirurgjike;

ndërhyrje ku kërkohet fushë më e mirë pune;

procedura ku kërkohet kontroll dhe manovrim më i saktë.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga grupi i OE rezulton se janë deklaruar modele T1 / T2 / T3, mirëpo asnjëri nga këto modele nuk dëshmon se është turbinë kirurgjikale me kokë të kthyer 45°. Modelet standarde nuk mund të konsiderohen ekuivalente me turbinë 45°, sepse mungon karakteristika kryesore e kërkuar nga DT.

Prandaj, produkti i deklaruar nuk e përmbush kërkesën për turbinë me kokë 45° dhe oferta është teknikisht e papërgjegjshme për këtë pikë.

Pretendimi 35 – Torque i mikromotorëve elektrikë te Uniti Dentar Kirurgjik

AK ka deklaruar se mikromotorët posedojnë torque deri në 2.4 Ncm / 3.0 Ncm dhe se kjo konsiderohet ekuivalente me kërkesën 2.7 Ncm.

Ky arsyetim është kontradiktor dhe i papabuar. DT ka kërkuar dy mikromotorë elektrikë brushless me shpejtësi 100–40,000 rpm dhe torque **2.7 Ncm apo ekuivalent**.

Nëse dokumentacioni i produktit të deklaruar tregon torque 2.4 Ncm, atëherë ky parametër është nën vlerën e kërkuar. AK nuk mund të deklarojë se 2.4 Ncm është ekuivalent me 2.7 Ncm pa pasur dëshmi teknike që funksionalisht ofron performancë të barabartë.

Për më tepër, vetë përgjigjja e AK-së është e paqartë, sepse përmend vlera të ndryshme 2.4 Ncm dhe 3.0 Ncm, pa sqaruar cili model konkret është i ofertuar dhe cili motor është pjesë e konfigurimit përfundimtar.

Në prokurim publik, përputhshmëria nuk mund të bazohet në kombinime të mundshme katalogu, por në produktin konkret të deklaruar dhe të nënvizuar në ofertë.

Prandaj, AK ka pranuar një parametër të paqartë dhe potencialisht më të ulët se minimumi i kërkuar.

Pretendimi 36 – Çmimi i hiperbolizuar i Unitit Dentar Kirurgjik

AK ka refuzuar pretendimin duke deklaruar se pajisja përfaqëson teknologji të avancuar dentare dhe kirurgjikale dhe se çmimi është brenda vlerës së parashikuar të kontratës.

Ky arsyetim nuk mjafton. Fakti që çmimi është brenda vlerës së parashikuar nuk e liron AK-në nga obligimi për të verifikuar nëse çmimi i ofertuar është i arsyeshëm dhe në përputhje me çmimin e tregut.

Vlera e ofertuar prej **69,660.00 €** për unitin dentar kirurgjik Axano – Dentsply Sirona është dukshëm e lartë dhe kërkon analizë reale nga AK.

Nga krahasimi me çmimet e tregut evropian, modeli Dentsply Sirona Axano ofrohet me çmime dukshëm më të ulëta, rreth 30,000.00 € për konfigurim bazë, ndërsa konfigurimet me pako shitesë SIVISION/SiroCam paraqiten afërsisht në këtë rang çmimi.

Prandaj, çmimi prej 69,660.00 € ngre dyshim të bazuar për çmim të fryrë dhe jo ekonomikisht të arsyeshëm. AK nuk ka bërë analizë të çmimit të tregut, nuk ka kërkuar sqarim dhe nuk ka arsyetuar pse një çmim kaq i lartë konsiderohet i pranueshëm.

Sipas parimeve të prokurimit publik dhe Rregullores Nr. 001/2022, AK ka obligim të sigurojë vlerë për parane publike dhe të mos kontraktojë me çmime më të larta se çmimi real i tregut.

ARTIKULLI 12 Sistemi Qendror i Thithjes për Njësitë Dentare

Pretendimi 37 – Kapaciteti i Sistemit Qendror të Thithjes

AK ka deklaruar se nga deklarata e prodhuesit DÛRR DENTAL SE rezulton se sistemi i ofruar është zgjidhje modulare me redundancë operative dhe se dy sisteme identike mund të funksionojnë si një njësi e vetme për të mbështetur kapacitet deri në 120 njësi dentare.

Ky arsyetim nuk qëndron.

Në DT është kërkuar qartë që sistemi qendror i thithjes të ketë kapacitet për jo më pak se **120 njësi dentare**.

Në ofertën e operatorit të rekomanduar është deklaruar një sistem modular i cili, sipas vetë dokumentacionit/deklaratës së prodhuesit, mbulon vetëm **60 njësi dentare**. Pra, kapaciteti real i një sistemi është vetëm gjysma e kapacitetit minimal të kërkuar.

AK ka tentuar ta paraqesë kombinimin e dy sistemeve si përmbushje të kërkesës. Mirëpo kjo nuk është e njëjtë me një sistem qendror të projektuar dhe të certifikuar për 120 njësi dentare. Në rast defekti të një moduli, sistemi do të vazhdonte funksionimin vetëm me gjysmën e kapacitetit të kërkuar, pra me 60 njësi, duke mos garantuar vazhdimësinë operative të kërkuar nga DT.

Kapaciteti i sistemit qendror të thithjes lidhet drejtpërdrejt me:

funksionimin paralel të njësisve dentare;

stabilitetin e vakumit;

sigurinë e punës;

vazhdimësinë e shërbimeve klinike;

funksionimin e pandërprerë në rast ngarkese të lartë.

Një sistem i projektuar për 60 njësi nuk mund të konsiderohet ekuivalent me kërkesën për 120 njësi.

Për më tepër, vetë deklarata e prodhuesit dëshmon kapacitetin më të ulët të secilit modul.

Prandaj, oferta nuk e përmbush specifikimin teknik të detyrueshëm për kapacitetin minimal të sistemit qendror të thithjes dhe duhet të shpallet e papërgjegjshme për këtë pozicion.

KUNDËRSHTIM NDAJ ARSYETIMEVE TË AK-SË PËR ELIMINIMIN E INTERLAB SH.P.K.

AK në vendimin e saj ka refuzuar pretendimet tona lidhur me arsyet e eliminimit, duke pretenduar se në dokumentacionin tonë nuk janë dëshmuar qartë disa specifika teknike.

Ky arsyetim është i pabazuar për këto arsye:

Së pari, produktet tona janë të identifikuar qartë me prodhues, model dhe dokumentacion teknik. Çdo paqartësi eventuale mbi ndonjë parametër specifik ka mundur të sqarohet përmes Nenit 72 të LPP-së dhe dispozitave përkatëse të Rregullores Nr. 001/2022, pa ndryshuar produktin, çmimin apo kushtet materiale të ofertës.

Së dyti, AK ka aplikuar Nenin 72 në mënyrë selektive. Për njërin anëtar të konzorciumit Madekos sh.p.k., AK ka kërkuar dokumente të pershtatshmërisë pas pretendimeve të ngritura, ndërsa për Interlab nuk ka lejuar sqarime për parametra teknike që kanë qenë të dëshmueshëm përmes dokumentacionit plotësues nga prodhuesi.

Së treti, AK ka bërë dallim të pajustificueshëm ndërmjet “paqartësive të sqarueshme” në ofertën e Interlab dhe “mangësive materiale” në ofertën e konzorciumit Bora Dental – Madekos. Për Interlab, AK ka trajtuar çdo mungesë eksplicite në katalog si arsye eliminimi, ndërsa për konzorciumin e rekomanduar ka pranuar edhe mospërputhje teknike të drejtpërdrejta.

Per ART.1 Tavolina e punes per Teknik dentar

Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar në mënyrë të plotë dhe substanciale pretendimet tona të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim.

AK është kufizuar në konstatime të përgjithshme se “nuk është dëshmuar” ose “nuk është nënvizuar qartë”, pa analizuar përmbajtjen konkrete të dokumentacionit teknik të dorëzuar.

Sa i përket prizave elektrike, AK nuk ka trajtuar faktin se manuali zyrtar i prodhuesit paraqet shprehimisht ekzistencën e prizës së tokëzuar me kapak mbi tavolinë dhe prizës së tokëzuar nën tavolinë, përkatësisht në pozicionet e kërkuara nga DT. AK nuk ka bërë vlerësim teknik të këtyre dëshmive, por është fokusuar vetëm në pretendimin formal se nuk është dëshmuar numri i prizave.

Sa i përket ndriçimit LED, AK nuk ka trajtuar parametrat teknikë të ndriçuesit Taneo TND, përfshirë kokën e lëvizshme dhe të rrotullueshme, zbehjen e vazhdueshme deri në 10%, temperaturën e ngjyrës 5,000 K, indeksin e riprodhimit të ngjyrave >90 dhe fluksin ndriçues rreth 2000 lm. Këta parametra dëshmojnë qartë se ndriçuesi është profesional dhe i përshtatshëm për përdorim laboratorik. AK e ka reduktuar kërkesën vetëm në ekzistencën e një difuzori, pa analizuar funksionin teknik të kërkuar: ndriçim uniform, pa hije dhe pa verbim.

Për rrjedhojë, përgjigjja e AK-së nuk përbën trajtim real të pretendimeve ankimore dhe nuk jep arsyetim teknik të mjaftueshëm për eliminimin e kompanisë sonë.

Per ART..3 Sistem lavatrice dezinfektuese

Ne si Operator Ekonomik konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë pretendimet dhe sqarimet tona të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim.

AK është kufizuar vetëm në konstatime të përgjithshme se nuk është dëshmuar përmeshja e specifikave, pa analizuar dokumentacionin teknik të dorëzuar dhe pa u përgjigjur në mënyrë konkrete ndaj dëshmive që ne i kemi paraqitur.

Lidhur me krahët rrotullues spërkatës

Ne kemi sqaruar se pajisja e ofruar nuk ka vetëm një krah rrotullues spërkatës, siç ka pretenduar AK. Në katalogun e dorëzuar për pajisjen e ofruar përmendet qartë formulimi **“spray arms”** dhe **“Wash chamber with spray arms”**, që do të thotë “krahë spërkatës” në shumës.

Pra, dokumentacioni teknik tregon se dhoma e larjes është e pajisur me krahë spërkatës, dhe jo vetëm me një krah. AK nuk e ka trajtuar këtë dëshmi dhe nuk ka dhënë asnjë arsytim teknik pse formulimi “spray arms” nuk është marrë për bazë gjatë vlerësimit.

Për këtë arsye, ne konsiderojmë se AK nuk ka bërë vlerësim real të katalogut, por vetëm ka përsëritur konstatimin e mëparshëm pa e analizuar dëshminë e paraqitur nga ana jonë.

Lidhur me programet e validuara dhe programet specifike

Ne kemi sqaruar se pajisja e ofruar posedon programe standarde, programe të paracaktuara dhe programe të personalizueshme. Në katalogun e dorëzuar thuhet qartë se pajisja ofrohet me programe të personalizueshme deri në **40 programe totale**.

Kjo dëshmon se pajisja nuk është pajisje bazike, por ka mundësi të avancuara programimi dhe përshtatjeje sipas nevojave të përdorimit.

AK nuk e ka trajtuar këtë dëshmi. Në vend që të analizojë nëse programet e paraqitura në katalog e plotësojnë kërkesën e DT-së, AK vetëm ka konstatuar në mënyrë të përgjithshme se programet nuk janë dëshmuar.

Lidhur me rigjenerimin e sistemit të zbutjes së ujit

Ne kemi paraqitur dëshmi nga katalogu ku thuhet qartë se makina automatikisht rigjeneron rrëshirat e sistemit të zbutjes së ujit, bazuar në fortësinë e ujit të vendosur gjatë instalimit. Ky funksion e plotëson kërkesën e DT-së për rigjenerimin e sistemit të zbutjes së ujit.

AK nuk e ka trajtuar këtë dhe nuk ka dhënë asnjë arsye teknike pse ky funksion nuk konsiderohet i mjaftueshëm. Përkundrazi, AK ka vazhduar të mbajë qëndrimin se kërkesa nuk është dëshmuar, pa u marrë me tekstin konkret të katalogut.

Lidhur me largimin e ajrit/avullit nga sistemi

Ne kemi sqaruar se pajisja posedon sistem efektiv të kondensimit të avullit, i cili redukton avullin gjatë fazave të dezinfektimit dhe tharjes. Ky funksion është i paraqitur në katalog si **“Steam condenser”**.

Gjithashtu, pajisja ka sistem tharjeje me ajër përmes filtrit **HEPA H14**, ku ajri shpërmdahet në mënyrë uniforme përmes krahëve spërkatës.

AK nuk i ka trajtuar këto funksione fare. Nuk është dhënë asnjë analizë se pse sistemi i kondensimit të avullit dhe sistemi i tharjes me ajër të filtruar nuk e plotësojnë kërkesën për largimin/reduktimin e ajrit dhe avullit nga sistemi.

Lidhur me ekranin me prekje dhe ndërfaqen e avancuar

Ne kemi sqaruar se pajisja e ofruar është e pajisur me ekran me prekje. Në katalog thuhet qartë se modeli AWD655-10A dhe variantet e tij janë të pajisura me ekran **7” touch-screen** në anën e

ngarkimit, po ashtu, në tabelën teknike është e shënuar prania e **Touch control panel**. AK nuk e ka trajtuar këtë dëshmi dhe nuk ka shpjeguar pse ekrani 7" touch-screen nuk është pranuar si përmbushje e kërkesës për ndërfaqe të avancuar.

Lidhur me funksionet e avancuara të monitorimit

Ne kemi sqaruar se pajisja ofron funksione të avancuara të monitorimit gjatë ciklit të punës. Katalogu tregon se ekrani grafik paraqet parametrat e ciklit, mesazhet e alarmit, temperaturat e sondave, temperaturën e tharjes dhe vlerën **A0**.

Gjithashtu, pajisja ka sistem **Alarm-check**, i cili i ndihmon operatorit të kuptojë shkakun e alarmit, si dhe sistem për monitorimin e presionit të ujit në kohë reale.

AK nuk i ka trajtuar këto dëshmi. Në përgjigjen e saj nuk ka asnjë analizë konkrete për këto funksione, edhe pse ato lidhen drejtpërdrejt me kërkesën për funksionalitete të avancuara të monitorimit.

Lidhur me lidhjen dhe menaxhimin e të dhënave

Ne kemi sqaruar se pajisja ka lidhje përmes porteve **USB** dhe **RS232**, si dhe mundësi për shkarkimin e historikut të programeve, cikleve dhe alarmeve. Katalogu po ashtu tregon se përmes USB-së mund të bëhet lidhja me kompjuter për programim dhe shkarkim të të dhënave.

AK nuk e ka trajtuar këtë pjesë të sqarimit tonë. AK është fokusuar vetëm te pretendimi për LAN/Wi-Fi, por nuk ka analizuar funksionet reale të komunikimit dhe menaxhimit të të dhënave që pajisja i ofron.

Lidhur me standardet dhe direktivat ndërkombëtare

Ne kemi paraqitur dëshmi se pajisja është në përputhje me standardet dhe direktivat ndërkombëtare. Në katalog janë të shënuara standardet:

EN ISO 15883, MDD, IEC, UL, EMC

Këto standarde dëshmojnë përputhshmërinë me kërkesat për larës/dezinfektues, pajisje mjekësore, siguri elektrike dhe përputhshmëri elektromagnetike.

AK nuk i ka trajtuar këto dëshmi dhe ka konstatuar në mënyrë të pasaktë se nuk është ofruar asnjë dëshmi për standardet ndërkombëtare. Ky konstatim nuk qëndron, sepse standardet janë të shënuara qartë në katalogun teknik.

Lidhur me markimin CE

Ne kemi dëshmuar se produkti mban markimin **CE 0123**, i cili është i paraqitur në dokumentacionin teknik të prodhuesit.

AK nuk e ka trajtuar këtë dëshmi fare. Nëse AK ka konsideruar se markimi CE nuk është i mjaftueshëm, atëherë ka qenë e detyruar të japë arsyetim teknik dhe ligjor për këtë, mirëpo një arsyetim i tillë mungon plotësisht në përgjigjen e AK-së.

Lidhur me aplikimin e nenit 72

Ne kemi sqaruar se disa dokumente, si ISO 13485, autorizimi i prodhuesit/distributorit, lista e pjesëve rezervë dhe deklarata për furnizim me pjesë rezervë për 10 vite, kanë ekzistuar dhe kanë qenë valide në momentin e dorëzimit të ofertës, por për arsye administrative nuk janë ngarkuar si pjesë e dokumentacionit të ofertës.

Për këtë arsye, kemi kërkuar që AK të aplikojë nenin 72 dhe të kërkojë informacione shtesë/sqarime. AK nuk e ka trajtuar këtë kërkesë në mënyrë të arsyetuar. Nuk ka shpjeguar pse nuk e ka përdorur mundësinë ligjore për të kërkuar sqarime, sidomos kur dokumentet kanë ekzistuar para afatit të dorëzimit dhe nuk do të ndryshonin substancën e ofertës.

Për Pozicionin 4 – Pajisja e vulosjes, tip i sheshtë

Ne konsiderojmë se AK nuk i ka trajtuar në mënyrë të plotë dhe teknike sqarimet tona për këtë pozicion. AK është fokusuar kryesisht te mungesat formale dhe te gjerësia e vulës 8 mm, por nuk ka analizuar dëshmitë konkrete të katalogut për funksionalitetin, validimin dhe standardet e pajisjes së ofruar.

1. AK nuk ka trajtuar faktin se pajisja është “validatable impulse sealer”

Ne kemi sqaruar se modeli i ofruar **hawo hm 460/660 AS-V** është pajisje profesionale për vulosje të paketimit steril dhe në katalog përshkruhet si: “**Validatable impulse sealers for the packaging of sealable pouches and reels.**”

AK nuk e ka analizuar këtë fakt dhe nuk ka dhënë arsytim pse një pajisje e validueshme për procesin e vulosjes nuk e përmbush qëllimin teknik të kërkesës.

AK nuk ka trajtuar dëshminë konkrete për EN ISO 11607-2:2019

AK ka konstatuar se nuk është ofruar dëshmi për standardin **EN ISO 11607-2**, mirëpo ky konstatim nuk qëndron. Ne kemi paraqitur dëshmi ku në katalog thuhet qartë: “**Validatable sealing process according to EN ISO 11607-2:2019.**” Po ashtu, në pjesën **Application and Certifications** është shënuar: “**Compliance with EN ISO 11607-2:2019.**”

AK nuk i ka trajtuar këto dëshmi dhe gabimisht ka vazhduar të pretendojë se është referuar vetëm EN ISO 11607-1.

AK nuk ka trajtuar kontrollin elektronik të parametrave për validim

Ne kemi sqaruar se pajisja ka: “**electronic parameter-control for process-validation**” dhe se kontrollon parametrat kryesorë të procesit të vulosjes, si: temperatura e vulosjes; koha e vulosjes; presioni i kontaktit; temperatura e ftohjes; koha e ftohjes.

AK nuk i ka analizuar këto parametra dhe nuk ka shpjeguar pse kontrolli elektronik i procesit nuk e përmbush kërkesën për monitorim dhe validim të vulosjes.

AK nuk ka trajtuar funksionalitetin real të pajisjes, por vetëm dimensionin 8 mm

Ne kemi sqaruar se gjerësia e vulës prej **8 mm** është standarde, funksionale dhe e validueshme për paketim steril mjekësor. Dallimi prej 2 mm nuk e cenon sigurinë e vulosjes, sidomos kur pajisja është e validueshme sipas **EN ISO 11607-2:2019**. AK nuk ka analizuar nëse ky devijim është thelbësor apo jo. Nuk ka dhënë asnjë arsytim teknik se pse vula 8 mm, e validuar sipas standardit përkatës, nuk garanton siguri dhe qëndrueshmëri të vulosjes.

AK nuk ka trajtuar pjesën për indikatorin/sinjalizimin në raport me kontrollin elektronik

AK ka thënë se nuk është dëshmuar indikator LED ose sinjali akustik, por nuk ka analizuar faktin se pajisja ka panel kontrolli, kontroll elektronik të parametrave dhe sistem për validim të procesit. Nëse AK ka pasur paqartësi për mënyrën e sinjalizimit, është dashur të kërkojë sqarim teknik sipas nenit 72, jo ta përdorë menjëherë si arsye eliminimi.

6. AK nuk ka trajtuar kërkesën tonë për aplikimin e nenit 72

Ne kemi sqaruar se dokumentet si ISO 13485, autorizimi, lista e pjesëve rezervë dhe deklarata për furnizim me pjesë rezervë për 10 vite kanë ekzistuar dhe kanë qenë valide në momentin e dorëzimit të ofertës, por nuk janë ngarkuar për arsye administrative.

AK nuk ka dhënë arsytim të mjaftueshëm pse nuk e ka përdorur nenin 72 për sqarime/informacione shtesë.

Ne konsiderojmë se AK nuk i ka trajtuar në mënyrë të plotë sqarimet tona teknike për këtë pozicion. AK është fokusuar vetëm në dallimet numerike 210°C/215°C dhe 13 m/min/15 m/min, por nuk ka analizuar funksionalitetin real, standardet dhe validimin e procesit të vulosjes.

AK nuk ka shqyrtuar përputhshmërinë me EN ISO 11607-2 Ne kemi sqaruar se pajisja është në përputhje me EN ISO 11607-2 dhe se procesi i vulosjes është i validueshëm sipas këtij standardi.

AK vetëm ka konstatuar se standardet nuk janë dëshmuar, por nuk ka analizuar pjesën e katalogut ku shënohet qartë:“Conformity EN ISO 11607-2” Kjo dëshmi është relevante dhe AK është dashur ta trajtojë konkretisht.

AK nuk ka shqyrtuar faktin se pajisja ka proces të monitoruar dhe të validueshëm Ne kemi sqaruar se pajisja monitoron parametrat kryesorë të vulosjes, përfshirë temperaturën, shpejtësinë, presionin dhe distancën e vulës nga skaji. AK nuk ka analizuar këto karakteristika dhe nuk ka dhënë arsytim pse një sistem i monitoruar dhe i validueshëm nuk e përmbush qëllimin teknik të kërkesës.

AK nuk ka shqyrtuar tolerancën teknike të temperaturës

AK ka thënë se pajisja arrin vetëm deri në 210°C, ndërsa kërkesa është 215°C. Ne kemi sqaruar se në katalog është paraqitur toleranca e fikjes/ndaljes sipas DIN 58953-7, me rregullim 2–5°C. AK nuk e ka trajtuar këtë sqarim dhe nuk ka analizuar nëse, me tolerancën teknike të lejuar, pajisja e përmbush funksionalisht kërkesën për temperaturë.

AK nuk ka shqyrtuar mundësinë “Other seam types available upon request”

Ne kemi sqaruar se katalogu përmban shënimin:“Other seam types available upon request”

Kjo tregon se konfigurime të tjera të vulosjes mund të ofrohen sipas kërkesës. AK nuk e ka trajtuar këtë pjesë dhe nuk ka kërkuar sqarim shtesë nga ne ose nga prodhuesi.

AK nuk ka shqyrtuar nëse dallimi 13 m/min kundrejt 15 m/min është devijim thelbësor AK ka konstatuar se pajisja ka shpejtësi 5–13 m/min, ndërsa është kërkuar deri në 15 m/min. Mirëpo AK nuk ka analizuar nëse ky dallim është thelbësor për funksionimin e pajisjes apo vetëm dallim formal. Ne kemi sqaruar se shpejtësia 5–13 m/min është shpejtësi e kontrolluar dhe e përshtatshme për proces të validueshëm të vulosjes. AK nuk e ka trajtuar këtë argument.

AK nuk ka shqyrtuar kërkesën tonë për nenin 72

Për kohën e përgatitjes pre-heating time ≤ 102 sekonda, ne kemi sqaruar se mungesa e kësaj të dhëne në katalog nuk do të thotë se pajisja nuk e përmbush kërkesën. AK është dashur të kërkojë sqarim shtesë sipas nenit 72, sidomos pasi bëhet fjalë për një të dhënë teknike që mund të sqarohet nga prodhuesi pa ndryshuar ofertën. AK nuk ka specifikuar cilat “standarde dhe kërkesa tjera” nuk janë dëshmuar

Për pozicionin nr 6 Autoklav me kapacitet të madh / Sterilizues me avull

Ne konsiderojmë se AK nuk ka bërë analizë të mirëfilltë teknike të ofertës sonë për Pozicionin 6. AK është kufizuar në konstatimin e përgjithshëm se pajisja është laboratorike/industriale, pa trajtuar dëshmitë konkrete se modeli Tuttnauer 5596 është në përputhje me EN IEC 61010-2-040, standard që lidhet me sterilizuesit për trajtimin e materialeve mjekësore.

AK nuk ka trajtuar kapacitetin prej 250 litrash, konfigurimin me dy dyer rrëshqitëse vertikale, programet e sterilizimit për instrumente të mbështjella, ngarkesa poroze dhe pako klinike, sistemin e vakumit dhe tharjes, lidhjet e ndara për dhomë dhe jacket, si dhe sistemin e avancuar të kontrollit dhe memories.

Po ashtu, AK nuk ka arsyetuar pse nuk ka aplikuar nenin 72 për dokumentet që kanë ekzistuar dhe kanë qenë valide në momentin e dorëzimit të ofertës. Për këtë arsye, ne konsiderojmë se përgjigjja e AK-së është formale, jo e plotë dhe nuk përmban analizë teknike të dëshmiave të paraqitura nga ana jonë.

7. Pozicioni “Autoklav me kapacitet të madh” – Tuttnauer 5596

AK pretendon se pajisja e ofruar është laboratorike/industriale dhe jo klinike. Ky pretendim është i gabuar. Modeli Tuttnauer 5596 është autoklav me kapacitet të madh, me dhomë 250 litra, i përshtatshëm për ngarkesa të mëdha, me konfigurim profesional dhe me mundësi programimi për cikle të ndryshme sterilizimi.

Fakti që pajisja mund të përdoret edhe në laborator nuk e përjashton përdorimin klinik. Shumë pajisje sterilizimi të nivelit të lartë kanë aplikim të dyfishtë laboratorik dhe spitalor. Ajo që ka rëndësi është nëse pajisja përmbush parametrat teknikë, ciklet, sigurinë dhe standardet e kërkuara.

Në kërkesën për rishqyrtim është sqaruar se pajisja ofron programe të shumta, përfshirë programe të personalizueshme, me temperatura deri në 138°C, që mundësojnë cikle klinike, cikle për tekstile, instrumente dhe ngarkesa të ndryshme. Pretendimi i AK-së se programet janë vetëm laboratorike është i pabazuar.

Lidhur me ciklet B, S, prion dhe tekstile, AK nuk ka analizuar faktin se pajisja me programe të personalizueshme lejon konfigurim të parametrave të kohës, temperaturës dhe vakumit sipas nevojave të sterilizimit. Kërkesa nuk duhet lexuar vetëm si emërtim i ciklit, por si aftësi funksionale për realizimin e ciklit.

Për standardet EN 285 dhe EN 17665, AK ka aplikuar qasje shumë rigide. Kur DT lejon standarde apo ekuivalencë, dokumentacioni duhet vlerësuar për përputhshmëri funksionale me kërkesat e sterilizimit me avull. Referimi në standarde të sigurisë elektrike dhe operative nuk mund të interpretohet si mungesë e përputhshmërisë, pa kërkuar sqarim nga prodhuesi.

Sa i përket nënvizimit në katalog, kjo është çështje formale dhe nuk mund të jetë bazë e vetme për eliminim, kur specifikat janë të lexueshme dhe të verifikueshme në dokumentacionin e prodhuesit. Nënvizimi shërben për lehtësim të vlerësimit, por mungesa e tij nuk e bën automatikisht pajisjen teknikisht jo-konforme.

Prandaj, AK ka gabuar në klasifikimin dhe vlerësimin e autoklavës së ofruar.

9. Pozicioni “Skaner intraoral me stacion mobil të integruar” – KaVo ProXam iOS

AK pretendon se nuk është dëshmuar përpunimi prej 800,000 pikave 3D në sekondë, thellësia e matjes 20 mm, workstation-i mobil dhe deklarata MDR. Këto pretendime janë të pabazuara dhe burojnë nga interpretim mekanik i specifikave.

Kërkesa për 800,000 pika 3D në sekondë është parametër që jo të gjithë prodhuesit e shprehin në të njëjtën mënyrë. DT ka përdorur edhe formulimin “ose ekuivalent”, që do të thotë se vlerësimi duhet të bëhet mbi performancën klinike dhe funksionale të skanerit, jo vetëm mbi një numër marketingu.

KaVo ProXam iOS ofron skanim intraoral të shpejtë, preciz, me ngjyra, me integrim në softuer klinik

dhe rrjedhë dixhitale të punës. Kjo përmbush qëllimin teknik të kërkesës për përpunim të avancuar 3D.

Edhe për thellësinë e matjes 20 mm, AK nuk ka marrë parasysh se prodhuesit e skanerëve intraoralë zakonisht nuk e paraqesin këtë parametër si matje lineare të izoluar, sepse performanca reale varet nga optika, algoritmet, softueri dhe saktësia klinike. Kërkesa duhet të vlerësohet si aftësi për të regjistruar struktura intraorale me thellësi të mjaftueshme klinike, gjë që KaVo ProXam iOS e përmbush.

Për workstation-in mobil, dokumentacioni i paraqitur tregon se sistemi është i konceptuar si zgjidhje mobile/klinike dhe se mund të përdoret me stacion mobil përkatës. AK ka gabuar kur ka izoluar një konfigurim alternativ desktop dhe e ka përdorur për të refuzuar gjithë pozicionin.

Lidhur me MDR, dokumentacioni teknik përmban shenja dhe referenca rregullative si CE, prodhuesi Planmeca Oy dhe standardet përkatëse. Nëse AK kërkonte dokument specifik të deklaratës, kjo mund të kërkohej si sqarim pa ndryshuar ofertën.

Prandaj, eliminimi për skanerin intraoral nuk është i bazuar në analizë të plotë teknike.

9. Pozicioni nr. 8 – Unit dentar

AK pretendon mungesë të listës së pjesëve rezervë, deklaratës 10-vjeçare dhe deklaratës MDR. Ky pretendim është formal dhe nuk merr parasysh dokumentacionin e prodhuesit KaVo.

KaVo është prodhues ndërkombëtar i pajisjeve dentare, me rrjet të strukturuar servisimi dhe furnizimi me pjesë rezervë. Për një pajisje komplekse si unit dentar, pjesët rezervë janë pjesë e dokumentacionit teknik, manualeve të servisimit dhe sistemit të prodhuesit. Mungesa e një dokumenti të veçantë me titull të saktë “lista e pjesëve rezervë”, nëse konsiderohet mangësi, është çështje formale dhe e sqarueshme.

Interlab ka dorëzuar autorizim dhe dokumentacion të prodhuesit. Në këtë kontekst, AK nuk mund të pretendojë se nuk ekziston mbështetje me pjesë rezervë, sidomos kur pajisja ka jetëgjatësi të deklaruar dhe rrjet të servisimit nga prodhuesi.

Sa i përket dritës operative, AK kërkon dimensione të fushës së dritës 200 x 100 mm.

Dokumentacioni teknik i KaVo Lumina duhet të lexohet në mënyrë funksionale: fusha e ndriçimit, intensiteti, homogjeniteti dhe fokusi klinik janë parametra të ndërlidhur. Nuk mund të refuzohet një dritë e avancuar klinike vetëm për shkak se AK kërkon interpretim gjeometrik të një dimensionit, pa analizuar ekuivalencën e performancës.

Prandaj, pretendimet e AK-së për unitin dentar nuk qëndrojnë.

10. Pozicioni nr. 9 – Unit dentar sipas ISO 7494

Për këtë pozicion, AK përsëri mbështetet në të njëjtin formalizëm: mungesë të një dokumenti të veçantë të listës së pjesëve rezervë dhe mungesë të dimensionit të fushës së dritës të shkruar në mënyrë identike në katalog.

Dokumentacioni i KaVo amiQa përmban pjesë, module dhe komponentë të pajisjes, përfshirë elemente të largueshme dhe pjesë të përdorimit teknik. Kjo është dëshmi se ekziston sistem i pjesëve dhe mirëmbajtjes. Një listë e veçantë me vulë/nënshkrim mund të kërkohej si sqarim, por nuk përbën mospërmbushje teknike të unitit.

Sa i përket dimensionit 170 x 85 mm, nga diagrami i KaVo Lumina rezulton fushë ndriçimi rreth 150 x 100 mm, pra sipërfaqe efektive e krahasueshme dhe funksionalisht ekuivalente me kërkesën.

Ekuivalenca nuk duhet të reduktohet në dimensione lineare absolute; duhet të vlerësohet sipërfaqja,

intensiteti dhe shpërndarja e dritës.

AK nuk ka kryer analizë të tillë funksionale dhe ka refuzuar ofertën mbi bazë të një formalizmi, në kundërshtim me parimin e vlerësimit objektiv.

Prandaj, pretendimi për pozicionin nr. 9 duhet të refuzohet.

11. Pozicioni nr. 10 – Njësi dentare sipas ISO 7494 me dritë të avancuar pa pulsime

AK pretendon se nuk është dëshmuar fusha minimale 92 x 52 mm ose ekuivalente. Ky pretendim është qartësisht i pabazuar, sepse dokumentacioni i KaVo Lumina paraqet fushë ndriçimi dukshëm më të madhe se kjo kërkesë.

Nga diagrami i dritës rezulton fushë ndriçimi rreth 150 x 100 mm, që tejkalon kërkesën minimale 92 x 52 mm. Në këtë rast, edhe sipas leximit më strikt, pajisja ofron performancë më të lartë se kërkesa minimale.

Pretendimi i AK-së se dimensionimi nuk është shkruar fjalë për fjalë në katalog nuk mund të qëndrojë, sepse dokumentacioni teknik grafik është pjesë e katalogut dhe është burim i vlefshëm për verifikimin e fushës së ndriçimit.

Për listat e pjesëve rezervë, vlen e njëjta: dokumentacioni teknik i KaVo përmban module, pjesë të largueshme, komponentë dhe elemente servisimi. Nëse AK kërkonte formë të veçantë me vulë dhe nënshkrim, kjo mund të kërkohej me Nenin 72.

Prandaj, arsyerja e eliminimit për këtë pozicion është e paqëndrueshme.

12. Pozicioni “Unit dentar kirurgjik” dhe kamera didaktike

Dokumentacioni I dorëzuar me oferte përmban pjesë, module dhe komponentë të pajisjes, përfshirë elemente të largueshme dhe pjesë të përdorimit teknik. Kjo është dëshmi se ekziston sistem i pjesëve dhe mirëmbajtjes. Një listë e veçantë me vulë/nënshkrim mund të kërkohej si sqarim, por nuk përbën mospërmbushje teknike të unitit

AK ka pranuar pjesërisht pretendimin për kamerën didaktike, duke evidentuar se ekziston referencë nga prodhuesi lidhur me përputhshmërinë me MDR. Ky fakt konfirmon se vlerësimi fillestar i AK-së ka qenë i nxituar dhe i paplotë.

13. Pozicioni nr. 12 – Sistemi Qendror i Thithjes për Njësitë Dentare

AK pretendon se sistemi Cattani nuk dëshmon përputhshmëri me HTM2022 apo të ngjashme, kontroll të presionit negativ, alarmim, BMS dhe mbështetje me pjesë rezervë. Këto pretendime bien ndesh me dokumentacionin e dorëzuar dhe me natyrën e sistemit të ofruar. Sistemi i ofruar nga Interlab është nga prodhuesi Cattani S.p.A., prodhues i specializuar ndërkombëtar për sisteme qendrore të thithjes dentare, kompresorë dhe sisteme vakumi për klinika të mëdha, spitale dhe universitete. Pra, nuk bëhet fjalë për pajisje të thjeshtë lokale, por për sistem qendror profesional. Kërkesa e DT-së ka qenë “HTM2022 apo të ngjashme”. Kjo do të thotë se AK ka lejuar ekuivalencë. Interlab ka ofruar sistem me kontroll të vakumit, funksionim të qëndrueshëm, teknologji inverter/VSD, monitorim dhe përshtatje sipas kërkesës së ngarkesës. Këto janë elemente që e bëjnë

sistemin funksionalisht të ngjashëm me kërkesat e sistemeve qendrore profesionale. Dokumentacioni tregon se sistemi nuk punon me thithje fikse të pakontrolluar, por me vakum të kontrolluar dhe të monitoruar. Kjo është pikërisht kërkesa funksionale e një sistemi qendror të sigurt për njësi dentare.

Për deklaratën e pjesëve rezervë, Interlab ka sqaruar se prodhuesi Cattani konfirmon furnizimin me pjesë rezervë për minimum 10 vite. Nëse AK ka kërkuar format specifik të listës, kjo është çështje e sqarueshme dhe jo bazë për eliminim.

Për këtë pozicion, AK ka bërë gabim thelbësor duke mos pranuar ekuivalencën funksionale të sistemit të ofruar dhe duke aplikuar një lexim formal të standardit HTM2022, edhe pse vetë DT lejonte formulimin “apo të ngjashme”. Prandaj, pretendimet e AK-së për sistemin qendror të thithjes janë të pabazuara.

III. KUNDËRSHTIM I PËRGJITHSHËM NDAJ QASJES SË AK-SË

AK ka ndërtuar arsyetimin e eliminimit mbi një premisë të gabuar: se çdo e dhënë që nuk është e shkruar në mënyrë identike në katalog duhet të konsiderohet mospërmbushje teknike. Kjo qasje nuk është në përputhje me parimet e prokurimit publik, sepse specifikat teknike duhet të vlerësohen në substancë dhe jo vetëm në formë.

Interlab ka ofruar produkte nga prodhues ndërkombëtarë të njohur, me dokumentacion teknik të gjerë dhe me konfigurime të avancuara. AK ka pasur bazë të mjaftueshme për të kërkuar sqarime për çdo çështje që e konsideronte të paqartë. Mospërmbushja e Nenit 72 dhe eliminimi i menjëhershëm për çështje të sqarueshme përbën shkelje të parimit të proporcionalitetit.

Në anën tjetër, ndaj ofertës së rekomanduar janë toleruar devijime më serioze, përfshirë produkte alternative, dokumente të paqarta, mospërputhje teknike dhe paqartësi në konfigurim. Kjo tregon standard të dyfishtë dhe vlerësim jo të barabartë.

AK nuk ka dëshmuar se ndonjë nga pretendimet e saj cenon substancën e ofertës së Interlab, ndryshon çmimin, ndryshon produktin apo e bën të pamundur furnizimin. Përkundrazi, shumica e pretendimeve kanë të bëjnë me mënyrën e paraqitjes së dokumenteve, nënvizimin, formulimin ose nevojën për sqarim teknik.

Kerkojme nga OSHP dhe ekspertit shqyrtues dhe Teknik qe te beje shqyrtimin e te gjitha pretendimeve ankimor te cilat I kemi paraqitur edhe ne kerkesen tone per rishqyrtim prane AK-se, me date 08.06.2026 per te cilat ne vendimin e AK-se verejme qe ne shumicen e pergjigjeve ndaj pretendimeve tona ankimore kane bere bishtnim dhe mos ofrim te fakteve te cilat e deshmojne te kunderten e pretendimeve tona ankimore, te cilat jane te bazuara ne fakte dhe te gjetura ne qasjen e marre nga ne prane AK-se, te cilat vertetojne qe oferta e konsorciumit eshte e papergjegjshme teknikisht dhe administrativisht.

Pas pranimit te Njoftimit B58 te dyte te dates 01.06.2026 te vendimit te AK per aktivitetin e

lartecukur, ne si OE kemi parashtruar kerkesen per qasje ne dokumentacionin e dorezuar nga konzorciumi Bora Dental SHPK dhe MADEKOS SHPK. Qasjen e kemi pranuar me daten 02.06.2026 ne formen elektronike.

Ne dokumentacionet e qasjes verejme se ju si AK keni kerkuara nga njeri antar i konzorciumit – Madekos shpk dokumentet e pershtatshmerise per te cilat ne si Operator Ekonomik kemi parashtruar pretendimet mbi mungesen e ketyre dokumenteve.

Kerkesa per rishqyrtim e dorezuar me daten 20.05.2026 nga ne si Operator Ekonomik pjesemarres ne kete aktivitet, nuk kemi pranuar pergjigjie ne asnje nga pretendimet tona ankimore e cila perben shkelje te rende te LPP-se nga AK.

Pas rishikimit te dokumenacionit ne si OE verejme mungesen e dokumenteve per antarin e konsorciumit Madekos SHPK sic eshte: Mungon Dokumentin: Autorizim zyrtar per nenshkruetin Ardian Buzuku e deklarates nen betim per kompanin Madekos shpk, qe si fillim i ben te pavlefshme keto dokumente qe e ben vendimin e AK-se B58 te pavlefshem.

Mungon deklarata per: Operatori Ekonomik në ofertë duhet të përfshijë edhe instalimin e sistemit qendror dhe lidhjeve të gypave për thithje nga sistemi qendror e deri tek secili unit dentar për secilën klinikë të QSKUK-së.

Pas analizimit te ofertes financiare e bere tek pershkrimi i cmimit i dorezuar nga konzorciumi Bora Dental – Madekos shpk verehet se komisioni vlersues nuk ka bere verejtur gabimin ne TVSH per artikullin 12 – Sistemi Qendror i Thithjes per njesite dentare ne vlere prej Çmimi për njësi pa TVSH – 240,000.00. Ky artikull ka kod doganor 841410000 per te cilat kategorizohet me TVSH 18% dhe jo me TVSH 8% sic ka ofertuar konzorciumi ne fjale. Andaj AK eshte i obliguar qe te veproje perkitazi LPP duke bere korigjimin e TVSH-se gjate vlersimit dhe para shpalljes se ofertes si fitues te ketij aktiviteti.

Ne si Operator Ekonomik jemi te shqetesuar lidhur me vlersimin e bere nga AK, pasice verehet qarte se ka pasur standarde te dyfishta gjate vlersimit, duke mos u munduar fare ne vlersimin e drejte te ofertes tone me produktet e ofruara me brendet me te njohura ne bote si Kavo, Tuttnauer, Havo, Atos dhe Cattani, per te cilat ne si OE kemi ofruar konfigurime disa here me te avancuara se oferta e konsorciumit Bora Dental shpk - Madekos shpk me difference afersisht 500,000 euro me e larte.

Dokumentacioni i konsorciumit i ofruar ka gene plotesisht i manget, i pacarte dhe me shume elemente tendence qe ka vendosur ne lajthitje Autoritetin Kontraktues QSKUK, qe e ben kete oferte teknikisht dhe administrativisht te papergjegjshme ne plotesi. Per te gjitha pretendimet mund te gjeni deshmitet te argumentuara me poshte.

OFERTA E BORA DENTAL SH.P.K MADEKOS SHPK E PAPERGJEGJSHME

Oferta e dorezuar nga konzorciumi Bora Dental dhe Madekos shpk eshte e papergjegjshme teknkisht dhe administrativisht pasice per pozicionin 1 Tavoline e punes per teknik dentar. Ne DT te publikuar nga AK me daten **27.02.2026 nuk jane autorizuar variante.**

Varijante	4.1	<p>Variante autorizohen: Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p> <p>[Nëse variantet janë të autorizuar, shëno:]]</p> <p>Tenderuesit janë të autorizuar që të dorëzojnë një tender duke propozuar një variant që përputhet me një variant të specifikimeve teknike. Tenderuesit duhet të dorëzojnë specifikimet teknike të variantes se ofruar.</p> <p>Specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga ndonjë variant janë të shënuara në specifikimet teknike të parashtruara në këtë dosje të tenderit, shih Aneksin 1.</p>
-----------	-----	--




- **Kërkesa në Dosjen e Tenderit:** Në Dosjen e Tenderit, Pjesa A, Seksioni II (Fleta e të Dhënave të Tenderit), Pika 4.1 thotë qartë: "*Variante autorizohen: Jo*".

Per pozicioni 1: Konzorciumi ne fjale ka ofruar dritën e tavolinës nga prodhuesi **Zeising** dhe njëkohësisht dritën nga **Renfert** (modeli *Light 1* jane te nenvizuar dy produkte me product code te ndryshem 25000600 dhe 25001600).

Qe ne thelb konzorciumi ka vendosur ne lajthitje Autoritetin Kontraktues duke ofruar 3 produkte per te njejtin pozicion. Kjo e ben te papergjegjshme kete oferte administrativisht.

Me poshte gjeni printscreen nga katalogjet e ofruara te konzorciumit te cilat i kemi pranuar gjate qasjes tek AK.

Dy dritat te ofruara nga prodhuesi Renfert:

Product Name		Scope of Delivery	Ref. No.
LIGHT 1 100-240V		Workstation lamp, table mounting, arm left	25000600
LIGHT 1 100-240V		Workplace light, wall mounting	25000700
LIGHT 1 100-240V US/JP		Workstation lamp, table mounting, arm left	25001600

Drita nga prodhuesi Zeising: Nuk ploteson kriterin 4000-6000 Lux, kjo drite ka ndriqeshmerine 2500 lux ne 100 cm ose 5000 lux ne 50 cm – Ky model nuk ploteson kerkesen minimale te dosjes se tenderit !

Dental Sky Top – LED Workstation Lighting

Construction	Vertical post with pantographic arm and metal housing
Material	Powder-coated metal construction, no plastic elements
Adjustment	Height adjustable from 50-100 cm above the worktop via integrated metal spring mechanism and adjustment knob
Illumination	Approx. 5000 LUX at 50 cm; approx. 2500 LUX at 100 cm
Light Technology	Latest LED technology, daylight quality 5000 K, CRI 80
Diffuser	Horizontal acrylic diffuser for uniform light distribution

LED Lifetime	Minimum 10,000 hours with integrated cooling system
Protection	Closed construction preventing dust and insects from entering
Application	Robust and durable design, suitable for laboratories and educational facilities

- për të njëjtin produkt, ofertuesi ka dorëzuar një "variant" të ofertës. Kjo është rreptësisht e ndaluar sipas rregullave të prokurimit kur variantet nuk janë të lejuara dhe përbën bazë për eliminim të menjëhershëm administrativ.

Mos plotesimi I specifikave Teknike të Tavolinës

Ne ofertën e dorëzuar nga konzorciumi Bora Dental dhe Madekos shpk eshte ofruar tavoline e cila nuk i ploteson specifikimet teknike ne DT

Mungesa e Kasetës Tërheqëse (Spring-loaded cassette): Dosja e Tenderit kërkon specifikisht:

Eshte kerkuar: Kasete duhet të ketë mekanizëm automatik tërheqjeje të tubit nëpërmjet një suste me dy spirale. Lidhja e ajrit të kompresuar duhet të jetë e integruar në panelin anësor, me mbajtës të pjerrët për vendosjen e grykës së ajrit. Kasete duhet të jetë e përbërë çelik inox ose çelik i veshur sipas EN/DIN/ASTM.

Eshte ofruar: Modeli NSK Ultimate XL nuk posedon kasetë metalike të tërheqjes me sustë me dy spirale nën standardet EN/DIN/ASTM. Ky mekanizëm i detyrueshëm mungon plotësisht.

Kjo e ben teknikisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi pasice ka ofruar produkt shume me te dobet ne performance se sa ai i kerkuar ne DT.

Eshte kerkuar: Sirtari i mbledhjes së mbetjeve duhet të jetë prej materiali rezistent ndaj korrozionit dhe kimikateve laboratorike dhe të jetë i përshtatshëm për pastrim me ujë të nxehtë ose avull.

Eshte ofruar: Plastika e ofruar nuk përballon pastrimin me avull të nxehtë me presion pa pësuar deformim termik (shkrirje ose lakim). Specifikim më i ulët se vlera fikse e kërkuar.

Kjo e ben teknikisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi pasice ka ofruar produkt shume me te dobet ne performance se sa ai i kerkuar ne DT.

Eshte kerkuar: Tavolina duhet të përfshijë gjithashtu dollap dysHEMEJE me tre sirtarë për ruajtje, me grykë ajri të integruar si pjesë e konfigurimit funksional. Dollapët të jenë nga materiale rezistente ndaj lagështirës dhe kimikateve, me mbrojtje kundër korrozionit dhe skaje të mbyllura hermetikisht.

Eshte ofruar: Dollapi me tre sirtarë i ofruar nga Zeising ka ndërtim standard laboratorik me buzë (skaje) të mbrojtura me shirita PVC/ABS.

Buzët e ngjitura me shirit ABS nuk përbëjnë "mbyllje hermetike" ndaj depërtimit të lëngjeve ose gazrave kimikë në rast derdhjeje

Kjo e ben teknikisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi pasice ka ofruar produkt shume me te dobet ne performance se sa ai i kerkuar ne DT.

Eshte kerkuar: Çertifikata e menaxhimit të cilësisë për pajisje mjekësore (Kapaciteti Teknik) per produktin NSK Ultimate XL – mikromotori per tavoline laboratorike.

Eshte ofruar Çertifikata zyrtare EN ISO 13485:2016 e dorëzuar për prodhuesin e mikromotorit (Nakanishi Inc. / NSK) qe ka si datë skadimi: 2026-04-26. Çertifikata ka skaduar zyrtarisht në para perfundimit te kohës te vlerësimit të tenderit (Maj 2026). Produkti konsiderohet ligjërisht i paçertifikuar.

Certificate

Quality Management System
EN ISO 13485:2016
EN ISO 13485:2016/AC:2018
EN ISO 13485:2016/A11:2021

Registration No.: SX 2002410-1

Certificate Holder: Nakanishi Inc.
700 Shimohinata,
Kanuma, Tochigi,
322-8666 Japan

Scope: Design and Development, Manufacture, Distribution and
Service of Instruments and Equipment in Dental and Surgical
Field.
(see attachments for products and additional sites included)

The Certification Body of TÜV Rheinland LGA Products GmbH certifies that the organization has established and applies a quality management system for medical devices.
Proof has been furnished that the requirements specified in the abovementioned standard are fulfilled. The quality management system is subject to yearly surveillance.

Report No.: 150300785-301

Effective date: 2025-04-28

Expiry date: 2026-04-26

Issue date: 2025-04-28

Replaces certificate SX 2002410-1 issued 2023-04-24

This certificate can be validated on <https://www.certipedia.com>



Nasu Yang
TÜV Rheinland LGA Products GmbH
Tillystraße 2 · 90431 Nürnberg · Germany

© TÜV, TÜEV and TÜV are registered trademarks. Utilisation and application requires prior approval.

Kjo e ben teknikisht dhe administrativisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi

Eshte kerkuar: Mikromotor Laboratorik Motori duhet të ofrojë torque minimal prej 7 Ncm ose më shumë dhe fuqi daljeje jo më pak se 150 W.

Eshte ofruar: NSK Ultimate XL me fuqi 46W I cili nuk I ploteson as per se afermi kerkesat e AK-se qe dmth ka ofruar produkt shume te dobet ne performance dhe kualitet ne krahasim me specifikimet teknike te detyrueshme minimale te kerkuara ne ANEKS 1 I DT.

Kjo e ben teknikisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi pasice ka ofruar produkt shume me te dobet ne performance se sa ai i kerkuar ne DT.

Dokumenti i dorezuar nga konzorciumi Bora Dental shpk dhe Madekos I prodhuesit Zeising per tavolinat dentare eshte i dyshimt dhe jo valid, pasice nuk permban asnje pershkrim te produktit per te cilen po deklarohet konformitetit EC, vule apo nenshkrim nga personi i cili ka leshuar kete dokument. Per me shume ky dokument nuk eshte valid per arsye qe direktivat e standardeve te perdorura kane skaduar per me shume se nje dekade. Kerkojme nga Autoriteti Kontraktues qe te verifikoj vertetesine e ketij dokumenti nga prodhuesi Zeising Germany !!!!

Direktiva e Makinerive 98/37/EC: Është shfuqizuar dhe zëvendësuar nga direktiva 2006/42/EC që në dhjetor të vitit 2009

Direktiva EMC (Përputhshmëria Elektromagnetike) 2004/108/EG: Është shfuqizuar dhe zëvendësuar nga direktiva 2014/30/EU që në prill të vitit 2016.

Direktiva e Tensionit të Ulët 2006/95/EG: Është shfuqizuar dhe zëvendësuar nga direktiva 2014/35/EU po ashtu në prill të vitit 2016.

Për një produkt që deklarohet konform në vitin 2026 , citimi i këtyre ligjeve të vjetra është i paligjshëm në tregun evropian.

Standardet Harmonizuese të vjetruara

Standardet EN 12100-1 dhe EN 12100-2 të listuara në dokument janë të vjetruara. Ato janë tërhequr nga qarkullimi dhe janë zëvendësuar nga një standard i vetëm i bashkuar, i quajtur EN ISO 12100:2010

Konzorciumi me kete ka arritur qe te vendos ne lajthitje AK-ne duke permbushur kriterin e deklarates se konformitetit per produktet ashtu sic eshte kerkuar ne DT.

Kjo e ben administrativisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi

Me poshte mund te gjeni te bashkangjitur EC declaraten e prodhuesit Zeising.



EC DECLARATION OF CONFORMITY
EG-Konformitätserklärung



Hersteller/ *Manufacturer:* Zeising Germany GmbH,
Preuschwiesen 1, 91227
Leinburg

Produkt(e)/ *Product:*

Seriennummer/ *Serial number:*

Einschlägige EG-Bestimmungen/ *Appropriate EC directives:* **EG-Maschinenrichtlinie 98/37/EG**
EC Machinery directive 98/37/EC
EMV-Richtlinie 2004/108/EG
EC Electromagnetic compatibility directive 2004/108/EC
EG-Niederspannungsrichtlinie 2006/95/EG
EC Low voltage directive 2006/95/EC

Angewendete harmonisierte Normen, insbesondere/
Applied harmonized standard in particular:

EN 12100-1
EN 12100-2
EN 61000-6-1
EN 61000-6-3
EN 60335-1

Hiermit wird bestätigt, dass das oben bezeichnete Produkt den genannten EG-Richtlinien entspricht.
We confirm that above mentioned product complies with the provisions of the named EC-Directives

Leinburg, 01.01.2026
Ort/ *Place, Datum/ Date*

Reiner Zeising
Geschäftsführer
Director

Shihet qarte se produkti i ofruar nga prodhuesi Zeising eshte ne pilot projektuese dhe jo nje produkt faktik egzistuese para se te publikohet aktiviteti ne fjale i QSKUK. Sipas LPP-se produkti i cili ofrohet ne aktivitetet publike duhet te jete paraegzistues dhe mire i testuar ne tregun mbare boteror. Nga katalogu dhe deklarata e konformitetit verehet qarte se prodhuesi nuk ka ofruar asnje numer apo emer te modelit per tavolinen e ofruar

- NSK Ultimate XL ofrohet vetëm me një mbajtëse të thjeshtë mbi tavolinë (*Handpiece Stand* prej plastike/gome) dhe kordon të lirë. Nuk ekziston fare sistemi kasetë i fshehur me tërheqje automatike.

Fuqia Elektrike (Watt): Dosja kërkon: "*Fuqi daljeje jo më pak se 150 W*".

- *Fakti:* Sipas Manualit të NSK (Seksioni 14. Specification), njësia kontrolluese (Control Unit) ka një konsum të energjisë prej vetëm **46 VA** (që është përafërsisht 46 W). Kjo është tri herë më e dobët se fuqia minimale prej 150 W e kërkuar nga AK.

Eshte kerkuar: Sistemi i filtrimit duhet të jetë shumëfazësh dhe të përfshijë qese filtrimi, mikrofiltër me efikasitet të lartë dhe filtër për neutralizimin e aromave

Eshte ofruar: Thithëse Renfert (Silent TS) qe kanë filtër pluhuri të Klasës M dhe mikrofiltra, por nuk kanë mundesi te adaptimit te nje filtër specifik me karbon aktiv për aromat të integruar.

Kjo e ben teknikisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi pasice ka ofruar produkt shume me te dobet ne performance se sa ai i kerkuar ne DT.

Eshte kerkuar: Rregullimi Automatik i Fuqisë "Rregullim automatik i fuqisë së thithjes sipas ngarkesës së punës".

Eshte ofruar: Te pajisjet Renfert, përshtatja e vazhdueshme e fuqisë së thithjes (automatic re-adjustment) vjen kryesisht në modelet EC2 ose TC2, por te modeli Silent TS fuqia rregullohet manualisht në 4 nivele nga tekniku.

Kjo e ben teknikisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi pasice ka ofruar produkt shume me te dobet ne performance se sa ai i kerkuar ne DT.

*Eshte kerkuar: **Sirtari i pastrueshëm me avull:** Kërkesa kërkon: "Sirtari i mbledhjes së mbetjeve... të jetë i përshtatshëm për pastrim me ujë të nxehtë ose avull".*

Eshte ofruar: Sistemet Renfert e mbledhin pluhurin në qese letre/sintetike brenda sirtarit. Sirtari vetë është thjesht mbajtës i qeses elektrike dhe jo një sirtar mbetjesh që dizajnohet për t'u larë i pavarur me ujë të nxehtë apo avull pas çdo përdorimi.

Kjo e ben teknikisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi pasice ka ofruar produkt shume me te dobet ne performance se sa ai i kerkuar ne DT.

Devijim i standardit të kërkuar për Instalimin e Gazit (Dështim Ligjor/Teknik)

- **Kërkesa e tenderit:** Specifikimet kërkojnë që të gjitha instalimet të plotësojnë standardet "sipas çdo standardi EN/ISO ose ekuivalent".

- Në faqen 4 të dokumentit *Zeising Catalog Workbenches.pdf*, tek pjesa e tubit të gazit (*Security Gas Hose for Bunsen Burner*), shkruhet shprehimisht se produkti është prodhuar sipas standardit gjerman "**Standard: DIN 30665**".
- Ofertuesi nuk ka ofruar asnjë certifikatë apo dëshmi të barasvlershmërisë (ekuivalencës) që vërteton se ky standard kombëtar gjerman (DIN) përputhet plotësisht me standardet evropiane (EN) apo ato ndërkombëtare (ISO) të kërkuara në mënyrë taksative nga Autoriteti Kontraktues.

Kjo e ben administrativisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi.

Artikulli 2: Karrige Laboratorike

Konzorciumi Bora Dental – Madekos ne kete pozicion ka ofruar nje karrige druri e cila ne parim nuk eshte e pershtatshme per periudha te gjata qendrimi gjate punes ne laborator teknik dentar.

Një karrige e thjeshtë druri (ideale për të shkatërruar shpinën e teknikut brenda javës së parë).

Vlera reale në treg: 75 € – 90 €.

Çmimi i faturuar shtetit: 1,168.20 € për cope.

Ky nuk është çmim abnormalisht i lartë – kjo është zhatje me paramendim. Konzorciumi po tenton t'i shesë shtetit dru me çmim ari, duke e ditur ekzaktësisht sa kushton ai produkt në treg.

Ky nuk është gabim kalkulimi. Është guxim i pastër kriminal i një kompanie që disa muaj më parë akuronte të tjerët për hajni, ndërsa sot kërkon mbi 1,100 euro për një karrige druri. Autoriteti Kontraktues e cila eshte ne kundershim me Nenin 1 dhe 6 duhet ta trajtojnë këtë ofertë jo si tender, por si provë materiale për hetuesi.

AK ka vepruar ne kundershim me Nenin 1 dhe 6 te LPP-se

RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar)

Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:

c. **të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.**

4.3 Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues.



Karriga e ofruar ne konzorciumi Bora Dental – Madekos shpk.

Artikulli 3: Sistem lavatriçe/dezinfektuese

Eshte kerkuar: Pajisja duhet të ketë funksion për monitorimin e përçueshmërisë së ujit të demineralizuar, **program për largimin e ajrit nga tubacionet**

Eshte ofruar: Sipas manualit inxhinierik të MELAG, modeli MELAtherm 10 Evolution nuk posedon një "Program" të tillë të zgjedhshëm në menunë kryesore të operimit (ku ndodhen programet: Universal, Quick, Intensive, Ophthalmology, Rinse). Largimi i ajrit nga tubacionet e dozimit (priming/venting) nuk është një program pune, por është një funksion i brendshëm i mirëmbajtjes (Maintenance Routine) i fshehur brenda menisë së shërbimit të teknikëve.

Arsyeja e skualifikimit: Dosja e tenderit e kërkon këtë si një program të integruar operativ. Duke qenë se ky funksion nuk mund të iniciohet si program i pavarur nga përdoruesi standard në ekran, pajisja shfaq specifikim më të ulët softuerik.

Kjo e ben teknikisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi pasice ka ofruar produkt shume me te dobet ne performance se sa ai i kerkuar ne DT.

Eshte kerkuar: program për largimin e ajrit nga tubacionet dhe program për rigjenerimin e njësisë së brendshme të zbutjes së ujit."

Eshte ofruar: MELAtherm 10 Evolution, njësia e brendshme e zbutjes së ujit (water softener) kryen rigjenerimin automatik në sfond (automatic regeneration), në varësi të shkallës së fortësisë së ujit të programuar dhe vëllimit të kaluar gjatë cikleve normale. Fabrika nuk ka paraparë dhe nuk ka ndërtuar një

program të veçantë dhe të pavarur për rigjenerim që mund të shtypet dhe të ekzekutohet me vete nga operatori.

Arsyeja e skualifikimit: Kërkesa fjalë për fjalë kërkon ekzistencën e një programi specifik për këtë proces. Mungesa e një programi të ndarë për rigjenerim manual (standalone regeneration program) thyen kriterin e detyrueshëm tekstual.

Kjo e ben teknikisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi pasice ka ofruar produkt shume me te dobet ne performance se sa ai i kerkuar ne DT.

Eshte kerkuar: Duhet të lejojë përshtatjen e parametrave të programit sipas rekomandimeve të përditësuara, mundësi për ndërprerjen e fazës së tharjes nga përdoruesi dhe përditësim të firmëare-it përmes media të jashtme."

Eshte ofruar: Melatherm 10, pajisja ka portë USB dhe slot për kartë CF (CompactFlash), protokollin i sigurisë mjekësore i fabrikës MELAG ndalon përditësimin e lirë të Firmware-it nga përdoruesi spitalor përmes një flash-drive apo karte. Përditësimi i kodit softuerik të makinës mund të bëhet ekskluzivisht nga një teknik i autorizuar dhe i trajnuar nga MELAG, duke përdorur vegla të dedikuara shërbimi dhe duke hapur panelin elektrik të pajisjes për qasje në motherboard.

Arsyeja e skualifikimit: Operatori ka ofruar një sistem ku përditësimi i firmware-it nuk mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga "mediat e jashtme" në mënyrë plug-and-play, gjë që shkel kuptimin fjalë për fjalë të lirisë operative të kërkuar në specifikim.

Kjo e ben teknikisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi pasice ka ofruar produkt shume me te dobet ne performance se sa ai i kerkuar ne DT.

Eshte kerkuar: mundësi për ndërprerjen e fazës së tharjes nga përdoruesi.

Eshte ofruar: Nëse përdoruesi shtyp butonin për të ndërprerë fazën aktive të tharjes (activeDRY) përpara kohës së paracaktuar në modelin Evolution, softueri i makinës regjistron një **paralajmërim/gabim në log** ("Drying aborted"). Ky veprim sjell që ciklin i plotë të lavatriçes të mos deklarohet si "I VALIDUAR PLOTËSISHT" në procesverbalin digjital, duke detyruar mjekun të nënshkruajë manualisht një thyerje protokollit.

• **Arsyeja e skualifikimit:** Sistemi nuk ofron një ndërprerje të pastër dhe të programuar të tharjes që ruan statusin e rregullt të ciklit pa gjeneruar mesazhe gabimi ose kufizime në validim, që paraqet specifikim më të ulët rregullator për një dhomë sterilizimi qendror.

Kjo e ben teknikisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi pasice ka ofruar produkt shume me te dobet ne performance se sa ai i kerkuar ne DT.

Artikulli 6


Madhësia e ekranit (Display Size)

- **Eshte kerkuar:** Ekranit me prekje me ngjyra duhet të ketë madhësi "jo më pak se 7 inç".
- **Eshte ofruar:** Paneli operativ i pajisjes Cliniclave përbëhet nga një ekran me prekje me ngjyra me madhësi **5.7 inç** ("colour 5.7 inch touch display"). Kjo nuk e përmbush minimumin e kërkuar prej 7 inç.

Kjo e ben teknikisht te papergjegjshme oferten e ketij konzorciumi pasice ka ofruar produkt shume me te dobet ne performance se sa ai i kerkuar ne DT.

Colour touch display

The operating panel consists of a colour 5.7 inch touch display.



Kapaciteti i memories së brendshme për ruajtjen e cikleve

- **Kërkesa e AK:** Ruajtje e të dhënave të paktën për **150 ciklet** e fundit.
- **Çfarë ofron MELAG:** Manuali i përdorimit thekson qartë se kapaciteti i memories së brendshme është i mjaftueshëm për afërsisht **100 log-e/cikle** ("The capacity is sufficient for approx. 100 logs"). Kjo është nën pragun e kërkuar nga AK.


Capacity of the internal log memory

The device is equipped with an internal log memory where all data from completed reprocessing programs are stored. The capacity is sufficient for approx. 100 logs. If the internal log memory becomes almost full and at least one log has not been output via an activated output medium, the following warning **Internal log memory is almost full** will appear. Prepare the output media specified in menu **Settings > Logging**. Print the relevant logs (menu **Log output**).

Rezervuari i brendshëm i ujit

- **Kërkesa e AK:** Pajisja duhet të ketë një rezervuar të brendshëm prej **15 litrash**.

